



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 58/2019 (JR)
Datë 12.11.2019

Vendim nr. 22 (JR)
Datë 22.07.2021

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 22.07.2021, ditën e enjte, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonči Petković, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Ilir Mustafaj, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKT: Shqyrtimi i vendimit nr. 180, datë 18.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e

ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Ilir Mustafaj, në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ushtronte detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në bazë të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të dispozitave të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni.
2. Komisioni administroi raportet e vlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016 dhe nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vendosi të përfundojë hetimin për subjektin e rivlerësimit Ilir Mustafaj, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi provat për këtë kriter, kishin arritur nivelin e provueshmërisë. Në përfundim, me vendimin nr. 180, datë 18.07.2019, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ilir Mustafaj.
3. Për vlerësimin e pasurisë, Komisioni arriti në përfundimin se, bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë. Në këtë vlerësim, Komisioni shtjelloi se subjekti i rivlerësimit:
 - i. nuk ka pasur mundësi të shlyente këstet e kredive bankare, për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzime të tjera dhe për të kursyer likuiditete në llogaritë bankare, me të ardhurat e ligjshme. Subjekti rezultoi në total me një bilanc negativ në vlerën -2.639.867 lekë gjatë tri viteve: 2009, për periudhën 01.01 deri 10.06.2011 dhe 2013;
 - ii. nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur sipas parashikimeve të paragrafëve 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës;
 - iii. nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

II. Shkaqet e ankimit

4. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) kundër vendimit të Komisionit, duke kërkuar ndryshimin e tij [vendimit] dhe konfirmimin në detyrë. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është i pabazuar në ligj dhe përbën shkelje të normave dhe rregullave ligjore për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, por edhe vlerësimit të gabuar të rrethanave faktike të rezultuara të vërtetuara gjatë procesit administrativ për hetimin dhe vlerësimin e kriterit të pasurisë.
5. Lidhur me pretendimet për shkelje procedurale, subjekti i rivlerësimit parashtron në mënyrë të përmbledhur se:
 - i. Komisioni paragjykoji haptazi çështjen, pasi vendosi të përfundojë hetimin vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
 - ii. Hetimi kryesisht në lidhje me kriteret që çmon Komisioni, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit për subjektin e rivlerësimit po nga e njëjta trupë gjykuese e Komisionit, cenon haptazi parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme.

- iii. Procedura e ndjekur ndaj tij dhe vendimi objekt ankimi, kanë elemente të theksuara të paragjykitimit, të një vendimi të paracaktuar, që ngrenë dyshime se ankuesi nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, që kënaq kërkesat e nenit 6 të KEDNj-së apo nenit 42 të Kushtetutës.
- iv. Komisioni nuk ka trajtuar drejt kërkesën e tij për përjashtimin e relatores së çështjes, në kontekst të parimeve të paanësisë dhe objektivitetit në gjykim, të parashikuara nga neni 6 i KEDNj-së dhe neni 42 i Kushtetutës.
- v. Komisioni ka refuzuar pa asnjë shkak kërkesën e subjektit për thirrjen e dëshmitarit, në kundërshtim me nenin Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 49, pika 9 dhe 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si dhe nenin 183 të Kodit të Procedurës Civile.
- vi. Seanca dëgjimore i është njoftuar në kundërshtim me nenin 179/2 të Kushtetutës, nenet 45 dhe 55 të ligjit nr. 84/2016, nenet 48, 59, 87, pika 2, germa “ç” e Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në kundërshtim me pikat 10 dhe 11 të aktit “Hapat proceduralë të unifikuar për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykuese të Komisionit”.
- vii. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë konkluzionet e ILDKPKI-së ndër vite, pa dhënë argumente dhe, për pasojë, ka kryer një vlerësim jo të drejtë mbi faktet dhe provat e administruara në kuadër të procesit të rivlerësimit.
- viii. Në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit mund të shkarkohet nëse plotësohen në mënyrë kumulative dhe jo alternative, bashkekzistenca e papërshtatshmërisë në lidhje me kriterin e pastërtisë së figurës dhe atë të pamjaftueshmërisë të pasurisë.
- ix. Në vendime të ndryshme, Komisioni ka mbajtur standard të dyfishtë, duke cenuar parimin e barazisë para ligjit të subjekteve të rivlerësimit.

6. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e pasurisë, konsistojnë në:

6.1 Për pasurinë, *apartament banimi me sipërfaqe 121 m²*, ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë.

a. Konkluzioni i Komisionit për pamjaftueshmëri burimesh për *blerjen e tokës dhe ndërtimin e katit të parë të ndërtesës*, pasuri që shërbyen si burim krijimi për pasurinë e deklaruar në deklaratën e pasurisë “vetting” [objekt shqyrtimi], nuk përputhet me provat e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, pasi nuk është përllogaritur saktë vlera e tokës e paguar realisht nga babai i subjektit, si dhe nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhura për ekzistencën dhe ligjshmërinë e të cilave subjekti paraqiti prova të mjaftueshme.

b. Në analizën financiare të kryer, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe familjes nga (i) *mësimdhënia*; (ii) *shitja e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale*; (iii) *shitja në tregun e fruta-perimeve përfituar nga prindërit e subjektit në periudhën 1997-2001*; (iv) *puna e vëllait të subjektit si emigrant në Greqi për periudhën 1991 – 2000 dhe kursimet e tij*; (v) *të ardhura interesi bankar*; (vi) *të ardhurat nga investimi në letra me vlerë e babait në shoqatën e të përndjekurve politikë gjatë viteve 1997-1998, Vlorë*; (vii) *të ardhurat nga pensioni i babait për vitin 2001*.

6.2. Për analizën financiare të vitit 2009:

a. Analiza financiare e Komisionit është e gabuar, pasi nuk janë marrë në konsideratë të ardhura të caktuara: (i) nga mësimdhënia në Universitetin {***}, për periudhën 2006-2009, të cilat janë tërhequr *cash* në vitin 2009 nga zyra e financës së Universitetit; (ii) 1000 euro të marra nga z. F. Xh. në vitin 2009, për të shlyer detyrimet ndaj të tretëve, shumë e cila është vlerësuar nga Komisioni si shpenzim, por jo si e ardhur.

b. Për shkak të mungesës së dokumentacionit financiar për periudhën 2007 – 2010 të Universitetit “{***}”, i mbyllur me vendim të Këshillit të Ministrave në vitin 2014, të ardhurat nga mësimdhënia për këtë periudhë nuk janë pasqyruar në deklaratën e pasurisë *vetting*.

c. Komisioni u dha deklaratave periodike vjetore vlerën e provës në referim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, duke i çmuar ato me rëndësi provuese për pasurinë objekt kontrolli, por nuk ka arsyetuar mbi provat e tjera bashkëlidhur shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit. Komisioni duhej të kishte marrë parasysht të gjitha rrethanat e të kishte vlerësuar objektivisht dhe në mënyrë proporcionale mësimdhënien për këtë periudhë, sipas deklaratave nga kolegë e studentë. Kjo mësimdhënie është në kufijtë e faktit të njohur botërisht.

6.3. Për analizën financiare të periudhës 01.01.2011 deri 10.06.2011:

a. Komisioni nuk ka përllogaritur të ardhurat në vlerën 400.000 lekë në këtë periudhë nga udhëheqja e diplomave në Universitetin {***}. Shuma në fjalë është tërhequr në fund të majit 2011 nga zyra e financës së universitetit, siç pasqyrohet në vërtetimin e datës 25.07.2011, fakt i pranuar edhe nga Komisioni në vendimin e arsyetuar, por jo në periudhën reale në të cilën ajo është përfituar.

b. Komisioni duhet të kishte përllogaritur shumën prej 600.000 lekësh, të përfituar nga miqtë dhe të afërmit e subjektit të rivlerësimit, gjatë vizitave të ceremonisë mortore pas vdekjes së nënës në mars 2011.

c. Në të ardhurat e vitit 2011 duhet të përfshihej edhe shuma 130.000 lekë, e përfituar nga pjesëmarrja në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore, të organizuar nga Universiteti “{***}” [Romë], deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2011. Ky fakt nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* për shkak të mosgjetyes së dokumentacionit përkatës nga grupi organizator i konferencës dhe për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, pasi kjo shumë është marrë *cash*.

6.4. Për analizën financiare të vitit 2013:

a. Ndryshe nga sa ka përllogaritur Komisioni, shpenzimet për shkollimin e djalit në vitin 2013 kanë qenë 300 euro. Pjesa tjetër, prej 600 eurosh, është paguar në vitin 2012, siç pasqyrohet në vërtetimin e datës 04.02.2019 nga shkolla “{***}”.

b. Familja ka pasur shpenzime për jetesë në një vlerë më të vogël se vlera që ka përcaktuar Komisioni në raportin e rezultateve të hetimit. Të ardhurat që ka pasur në dispozicion familja kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e bëra gjatë këtij viti.

c. Për vitin akademik 2012-2013 është tërhequr *cash* nga Universiteti {***} shuma prej 210.000 lekësh nga udhëheqja e diplomave. Ky fakt është pasqyruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2012, si dhe në dokumentacionin shoqërues të deklaratës. Kjo shumë, në fund të vitit 2012, ka qenë gjendje dhe është përdorur gjatë vitit 2013.

III. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit

A. Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjykimit

7. Subjekti kërkon *shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e tij, duke riçelur/përsëritur hetimin gjyqësor me qëllim marrjen në shqyrtim dhe analizim të provave të depozituara në dosjen e Komisionit, në funksion të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike*. Hetimi i Komisionit është i pavlefshëm, për shkak të shkeljeve procedurale të kryera.

Komisioni ka treguar doza të larta paragjykimi dhe ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga qëndrimet e mëparshme për subjektet e tjera me problematika të ngjashme.

7.1. Bashkëlidhur ankimit, subjekti ka përcjellë disa akte shkresore¹, të cilat ka kërkuar të merren në cilësinë e provës nga Kolegji. Ndër këto akte, katër janë deklarata noteriale të kryera nga individë të ndryshëm gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit. Po ashtu, subjekti ka përcjellë dy (2) vërtetime, të lëshuara nga institucione të pushtetit vendor [Ersekë], dhe katër (4) vendime të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në lidhje me kandidimin e subjektit në Gjykatën Kushtetuese. Së fundmi, subjekti ka përcjellë edhe një shtesë, aktvlerësimi kontabël.

7.2. Në zbatim të parashikimeve të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, gjatë procesit gjyqësor, Kolegji zbaton një grup dispozitash të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar [në vijim “ligji nr. 49/2012”], përfshirë dhe nenet 47, 49 dhe 51 të tij. Trupi gjykues i Kolegjit analizoi së pari kërkesat me natyrë procedurale të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në përmbajtje të ankimit, që kanë të bëjnë kryesisht me kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, riçeljen e hetimit gjyqësor, rivlerësimin e provave të administruara nga Komisioni dhe administrimin e akteve bashkëlidhur ankimit në cilësinë e provave.

7.3. Në vijim të sa më sipër, nga leximi harmonik i parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për sa u përket provave, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vlerësimi i provave dhe i akteve të administruara gjatë procesit të zhvilluar në Komision, është pjesë e qenësishme e procedurës së analizimit të shkaqeve të ankimit nga Kolegji. Në të njëjtën kohë, aktet bashkëlidhur ankimit nga subjekti, nuk rezultojnë të pasqyrojnë fakte të reja pas dhënies së vendimit të Komisionit. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar apo as argumentuar pamundësinë e paraqitjes së këtyre akteve që në fazën e hetimit administrativ në Komision, që do të lejonte kalimin e testit të vendosur nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012², sa i përket mundësisë së ankuesit për të paraqitur prova të reja me ankimin. Edhe në një analizë alternative, bazuar në përmbajtjen e akteve, trupi gjykues sjell në vëmendje se deklaratat noteriale të sjella kanë karakter deklarativ dhe nuk harmonizohen me dokumentacion tjetër ligjor. Po ashtu, vendimet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit të z. Ilir Mustafaj në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, nuk mund të cilësohen si dokument provues në kriterin e vlerësimit të pasurisë. Edhe dokumentet e tjera u vlerësuan nga trupi gjykues të panevojshme dhe pa ndikim në vendimmarrjen e Kolegjit, në kuptim të nenit 49, pika 6³ e ligjit nr. 84/2016.

7.4. Trupi gjykues i Kolegjit po ashtu konstatoi se nga analiza e ankimit nuk rezulton që zbatohet ndonjë nga rrethanat e parashikuara nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 që do të

¹ Aktet shkresore bashkëlidhur ankimit konsistojnë në: (i) Deklarata noteriale të datës 04.11.2019 nga z. G. M., znj. E. B., z. E. P., dhe një të datës 24.10.2019 nga z. L. M.. (ii) Vërtetim, datë 25.10.2019, i Njesisë Administrative Qendër, Ersekë dhe vërtetim i datës 25.10.2019, i kryetarit të fshatit {***} – Poshtë, Njësia Administrative Qendër, Ersekë. (iii) Vendime të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 65, 66, 67 dhe 68, të datës 24.07.2019, të cilat kanë disponuar ndalimin e kandidimit të subjektit të rivlerësimit në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të vendimit të Komisionit objekt ankimi. (iv) Aktekspertimi, datë 04.11.2019, nga eksperti kontabël B. P.

² Kjo dispozitë parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

³ Neni 49, pika 6, ndër të tjera, përcakton sa vijon: “[6]. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit [...]”.

bënin të nevojshëm shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. Analiza e shkaqeve të ankimit me natyrë procedurale e materiale shtjellohet më poshtë në këtë vendim.

7.5. Në përmbledhje, trupi gjykues i Kolegjit vendosi që çështja e rivlerësimit që i përket subjektit të rivlerësimit Ilir Mustafaj, të merrej në shqyrtim në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i pretendimeve që lidhen me cenimin e parimeve procedurale

8. *Subjekti pretendon se vendimi i Komisionit është rezultat i një hetimi të paplotë dhe të pabazuar në Kushtetutë e në ligj. Subjekti ka kërkuar hetim administrativ për të tria elementet e rivlerësimit. Në vendimin e arsyetuar nuk ka referencë në kontrollin e figurës apo vlerësimin e aftësive profesionale. Komisioni ka paragjykuar haptazi çështjen duke përfunduar hetimin vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.*

8.1. Nga shqyrtimi i vendimit objekt ankimi, rezulton se Komisioni ka administruar të tria raportet e vlerësimit. Në përfundim, Komisioni ka vendosur të përfundojë hetimin vetëm për kriterin e *vlerësimit të pasurisë*, pasi provat për këtë kriter, kishin arritur nivelin e provueshmërisë. Pasi u njoh me rezultatet e hetimit paraprak të përcjella më datë 13.05.2019 nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit kërkoi që rivlerësimi të bëhej për të tria kriteret. Këtë pretendim subjekti e ka ngritur edhe në kërkesën për përjashtimin e relatores së çështjes, gjatë seancave dëgjimore të datës 14.06.2019 dhe të datës 11.07.2019.

8.2. Trupi gjykues i Kolegjit, vëren se pretendimi për paragjykim të çështjes për subjektin e rivlerësimit Ilir Mustafaj për shkak të vendimmarrjes dhe hetimit administrativ vetëm në një kriter, është i pabazuar. Vendimi i Komisionit është marrë në përputhje me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton qartë se institucionet e rivlerësimit mund të kryejnë vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar *në një ose disa prej kriterëve*. Ky qëndrim i Komisionit është konsoliduar tashmë dhe në jurisprudencën e Kolegjit⁴. Në zbatim të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për konfirmimin në detyrë të subjektit, kërkohet plotësimi së bashku i kushteve për të tria kriteret e rivlerësimit – vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Nëse subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, edhe nëse vlerësimi për dy kriteret e tjera do të ishte pozitiv, institucionet e rivlerësimit japin masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në interpretim të këtyre dy dispozitave ligjore, nëse pas kalimit të barrës së provës subjekti i rivlerësimit arrin të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ për kriterin e vlerësuar, Komisioni zhvillon hetim administrativ dhe i nënshton vlerësimit edhe kriteret e tjera. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

9. *Subjekti pretendon se hetimi kryesisht në lidhje me kriteret që çmon Komisioni, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit për subjektin e rivlerësimit po nga e njëjta trupë gjyqësore e Komisionit, cenon haptazi parimin e gjyqësisë nga një gjykatë e paanshme. Në veprimtarinë e Komisionit e njëjta trupë gjyqësore edhe heton faktet, edhe jep vendim në lidhje me gjetjet e bëra nga ajo vetë, pra është një organ me natyrë të dyfishtë, “organ akuzator” dhe “gjykatë”. Kërkesat e parashikuara nga ligji për paanësi objektive të trupës gjyqësore të Komisionit, nuk mund të lejojnë që anëtarët e trupës gjyqësore të ushtrojnë si funksione hetimore, ashtu edhe gjyqësore.*

9.1. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e nenit 6 të Konventës Evropiane

⁴Shih, ndër të tjera, vendimet nr. 29, datë 08.11.2019; nr. 1, datë 31.01.2019, nr. 17, datë 15.07.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

për të Drejtat e Njeriut [KEDNj], në drejtim të garantimit të pavarësisë dhe paanësisë, u është nënshtruar filtrave të analizës së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, certifikuar në fillim të procesit nga Komisioni i Venecias⁵, ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese⁶ dhe së fundmi është konfirmuar edhe nga shqyrtimi në praktikë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GjEDNj] në vendimin që i përket Xhoxhaj kundër Shqipërisë⁷. Në këtë të fundit, GjEDNj-ja nuk konstatoi shkelje të nenit 6 §1 të KEDNj-së lidhur me mënyrën e funksionimit të Komisionit dhe Kolegjit. Në paragrafët 307 dhe 308, GjEDNj-ja ka konstatuar edhe që mënyra se si funksionojnë institucionet e rivlerësimit përmbush standardet e KEDNj-së, dhe është gjetur e drejtë⁸. Ky pretendim i subjektit lidhet me funksionimin dhe organizimin e institucioneve që realizojnë procesin e rivlerësimit, në kontekstin e parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, dhe jo me veprime të Komisionit që lidhen me rivlerësimin e subjektit individualisht. Ky aspekt i funksionimit të procesit të rivlerësimit nëpërmjet organeve që e kryejnë atë, është analizuar dhe gjetur në përputhje me të gjitha garancitë e nevojshme për zhvillimin dhe respektimin e një procesi të rregullt ligjor nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017 – paragrafët 38 dhe 67⁹ – dhe Komisioni i Venecias¹⁰. Pretendimi i subjektit për cenim të parimit të paanësisë dhe, për rrjedhojë, të procesit të rregullt ligjor, për shkak se e njëjta trupë gjykimi heton dhe vendos, është i pabazuar. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk qëndron pasi nuk gjendet i mbështetur në ligj.

9.2. Sa më sipër, pasqyrohet gjerësisht në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit¹¹. Në këto arsytetime të mëparshme, Kolegji ka gjetur që kompetencat e Komisionit për të kryer hetimin administrativ dhe për të dhënë vendimin janë në përputhje të plotë me natyrën e procesit të rivlerësimit, si një proces administrativ i nisur kryesisht, në përputhje me tagrat që i njej Kushtetuta, Aneksi i saj dhe ligji nr. 84/2016 në kreun VII, “Procedura e rivlerësimit”, në të cilin përcaktohen kompetencat hetimore dhe vendimmarrëse të Komisionit. Sa më sipër, pretendimi i ngritur nga subjekti i rivlerësimit është i pabazuar.

- 10.** *Procedura e ndjekur nga Komisioni dhe vendimi objekt ankimi, kanë elemente të theksuara të paragjyqimit e të një vendimi të paracaktuar, parashtron subjekti.* Sipas tij, këto aspekte vënë në dyshim gjykimin e tij nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, që kënaq kërkesat e nenit 6 të KEDNj-së dhe nenit 42 të Kushtetutës. Në rastin konkret, konstatohet që trupi gjykues i Komisionit ka vepruar “nën doza të larta paragjykimi” dhe në shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë.

10.1. Nga shqyrtimi i akteve të administruara, trupi gjykues i Kolegjit nuk vëren të dhëna që të provojnë ose sugjerojnë në ndonjë formë që vendimmarrja për subjektin e rivlerësimit ka qenë e paracaktuar. Përpos kësaj, vetë subjekti nuk shtjellon se çfarë e motivon këtë lloj sjelljeje të Komisionit, sikurse nuk e ilustron atë me rrethana objektive. Nga komunikimet e subjektit me Komisionin, pyetjet e dërguara për të sqaruar rrethanat dhe faktet, rezultatet e hetimit administrativ, si dhe qëndrimi në seancat dëgjimore, nuk rezultojnë indicie për “doza paragjykimi” në sjelljen e Komisionit, apo elemente të tjera që të kenë cenuar procesin e rivlerësimit të subjektit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 6 të KEDNj-së, nenit 42 të Kushtetutës apo ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit të subjektit ka zgjatur 10 muaj, prej datës 07.09.2018 kur i është përcjellë pyetësori i parë e deri më datë 11.07.2019, kur është

⁵ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

⁶ Shih vendimet nr. 2/2017 dhe nr. 78/2017 - http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php

⁷ <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-208053>.

⁸ <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22tabview%22:%7B%22document%22%7D,%22itemid%22:%7B%22001-208053%22%7D%7D>.

⁹ http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

¹⁰ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

¹¹ Shih vendimin nr. 4, datë 09.02.2021 (paragrafi 8) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

zhvilluar seanca dëgjimore, gjë që përjashton mundësinë teorike për vendimmarrje që nuk i ka lejuar subjektit kohën e nevojshme për të përgatitur përgjigjet dhe prapësimet e tij.

10.2. Përpos sa më sipër, procesi i rivlerësimit është tërësisht administrativ dhe kryhet mbi parimet e parashikuara në ligjin nr. 84/2016 dhe, kur është rasti, mund të zbatohen edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin për gjykatat administrative. Ndërkohë, parimi i prezumimit të pafajësisë është një parim i procesit penal, çka nuk gjen zbatim dhe mbështetje në këtë proces. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk qëndron pasi nuk gjendet i mbështetur në ligj.

- 11.** *Komisioni ka shkelur parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme.* Trupa gjykuese është futur në seancë dëgjimore në orën 17:00 të datës 14.06.2019, pa lexuar provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Ka qenë objektivisht e pamundur që 360 faqe të trajtoheshin prej trupës gjykuese për më pak se 24 orë, nga momenti i dorëzimit e deri në fillimin e seancës dëgjimore, apo për përkthimin e tyre për vëzhguesin ndërkombëtar. Një shkelje e tillë është cenim i rëndë i procesit të rregullt ligjor.

11.1. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit depozitoi shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë më datë 10.06.2019. Shpjegimet ishin shoqëruar me dokumentacion mbështetës prej 366 fletësh. Dy ditë më pas, trupi gjykues i Komisionit ka vendosur të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore më datë 14.06.2019. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar shtyrjen e seancës për shkak të një seance gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe meqenëse periudha njëditore ishte e pamjaftueshme për t'u përgatitur. Në të njëjtin *e-mail*, subjekti kërkoi të njihet me rezultatet e hetimit edhe për dy kriteret e tjera të vlerësimit, pasi sipas tij, neni 4, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përcakton që rivlerësimi kryhet mbi bazën e tri kriterëve. Duke vlerësuar se afati 30-ditor nga njohja me rezultatet e hetimit ishte e mjaftueshme për përgatitjen e shpjegimeve e provave lidhur me to, Komisioni shtyu seancën dëgjimore për orën 17:00 të së njëjtës datë të caktuar fillimisht – 14.06.2019.

11.2. Lidhur me çështjen që lidhet me mjaftueshmërinë e kohës që Komisioni kishte në dispozicion për të shqyrtuar parashtrimet e subjektit, të përbëra “prej 366 fletëve” sipas tij, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se një analizë objektive duhet të mbështetet në cilësinë dhe jo sasinë e të dhënave të përmbajtura, në raport me provimin e të kundërtës së rezultateve të hetimit administrativ. Sjellim në vëmendje në këtë kontekst që, nga aktet në fashikull, rezultojnë që ndër 366 fletët, 36 prej tyre konsistojnë në kopje dokumentesh identifikimi (ID) të personave të ndryshëm (certifikatë, kopje karte identiteti/pasaportë) ose 10% e volumit total, 8 fletë diploma/dëshmi/vërtetim/certifikatë notash të subjektit të rivlerësimit, 14 kopje diplomash universitare të studentëve në Universitetin {***}, 5 fletë vërtetim nënshkrimi/përkthimi/njësime origjinalin, të cilat për nga natyra kërkojnë kohë minimale për shqyrtimin e tyre. Po ashtu, subjekti me këto parashtrime ka përcjellë edhe 29 fletë në gjuhën gjermane [shih poshtëshënimin nr. 37 (iii)] dhe dokumente të cilat ishin përcjellë me deklaratën e pasurisë *vetting*, apo që ishin përsëritje e atyre të përcjella prej tij në përgjigje të pyetësorëve, apo akte tashmë të administruara nga Komisioni si rezultat i hetimit të kryer kryesisht¹².

¹² Ndër to, subjekti ka përcjellë edhe një vërtetim të datës 25.07.2011 nga Universiteti {***}, një urdhër-xhirimi, 12 fletë përgjigje dhe dokumentacion arkivor i ASCAL [paragrafi 30.3 faqe 33], ekstrakt historik i shoqërisë {***}, {***}, {***}, licencë shoqërie, certifikatë regjistrimi NIPT, kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.06.2011, së bashku me anekset e saj, kontratë shkëmbimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.05.2018 [14 fletë], 4 fletë kopje e dosjes gjyqësore së A. P. për të cilën ka kërkuar heqjen dorë nga çështja [poshtëshënimi 44], vendime/leje ndërtimi/planimetri sheshi të KRRT, Komuna {***}.

11.3. Në përmbledhje, një analizë e çfarë rezulton realisht të kenë qenë përgjigje të çështjeve të shtruara në funksion të barrës së provës nga subjekti për rezultatet e hetimit administrativ, rezulton që periudha kohore në dispozicion të Komisionit ka qenë katër ditë nga data 10.06.2019 [kur u dorëzuan këto akte] deri më datë 14.06.2019 [seanca e parë dëgjimore] – dhe jo 24 orë, siç pretendon subjekti. Së dyti, duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e akteve të sjella njiheshin nga Komisioni ose rezultojnë pa ndikim për kontrollin e pasurisë, periudha katërditore nuk mund të vlerësohet e pamjaftueshme për shqyrtimin e tyre. Për pasojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për vendim të paracaktuar, bazuar vetëm në një përlllogaritje të tij të një numri të fryrë të shpjegimeve vetëm për shkak të volumit të dokumenteve, është i pabazuar.

11.4. Mjaftueshmërinë e kohës e ka sjellë në vëmendje edhe kryesuesi i trupit gjykues në Komision gjatë seancës dëgjimore të datës 14.06.2019, duke shpjeguar edhe që oraret e ndjekura nga Komisioni apo mënyra e organizimit të punës lejojnë kohë të mjaftueshme për konsultimin me dokumentet, ndërsa seanca dëgjimore përbën mundësi për subjektet për të argumentuar dhe plotësuar sa është paraqitur me shkrim. Së fundmi, nga aktet në fashikull, rezulton që me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e relatores, seanca dëgjimore e datës 14.06.2019 u shty më datë 11.07.2019, duke i dhënë subjektit 27 ditë të tjera për të përgatitur kundërgjendimet e tij. Në momentin e marrjes së vendimit, trupa gjykuese ka pasur kohë të bollshme për të njohur e analizuar të gjitha aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjekti të rivlerësimit, i vlerësuar në çdo plan teorik dhe praktik, është i pabazuar.

12. *Subjekti ka ngritur një sërë pretendimesh në lidhje me kërkesën e tij për përjashtimin e komisioneres relatores. Sipas tij, vendimi i marrë për rrëzimin e kërkesës përbën shkelje të parimeve të paanësisë dhe objektivitetit në gjykim, të parashikuara nga neni 6 i KEDNj-së dhe neni 42 i Kushtetutës. Në seancën e datës 11.07.2019, subjekti ka sjellë në vëmendje të trupës gjykuese të Komisionit e-mail-in e datës 19.06.2019, ku shprehet qëndrimi i mbajtur nga relatorja e çështjes rreth kërkesës për përjashtimin e saj, në përmbajtje të të cilit, sipas subjektit, ka pohime të saj dhe të anëtarëve të tjerë të trupës gjykuese, që janë paragjykuese, dhe përbëjnë cenim të rëndë të procesit të rregullt ligjor. Ky fakt ka detyruar vëzhguesin ndërkombëtar të paraqesë një mendim/opinion, sipas të cilit trupi gjykues duhet të arsyetojë në vendim të gjitha argumentet e subjektit të rivlerësimit për procesin e rregullt ligjor.*

12.1. Nga procesverbali i seancës dëgjimore të datës 14.06.2019, trupi gjykues konstaton kërkesën e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për përjashtimin e relatores së çështjes Xh. P., për rrethana konkrete arsye serioze njëanshmërie, duke parashtruar pretendimet e tij në referencë të nenit 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile. Në vijim, trupi gjykues i Komisionit vendosi të ndërpresë seancën dëgjimore, për të mundësuar që kërkesa e subjektit të rivlerësimit të shqyrtohej nga një trup tjetër gjykues. Më datë 19.06.2019, relatorja ka përcjellë shpjegimet e saj lidhur me pretendimet e ngritura nga subjekti në kërkesën për përjashtim. Më tej, trupi gjykues ka zhvilluar një bisedë telefonike me relatoren, dokumentuar në procesverbal. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit vendosi të rrëzojë kërkesën e subjektit për përjashtimin e relatores së çështjes si të pabazuar në ligj dhe në prova.

12.2. Trupi gjykues i Komisionit ka arsyetuar se nuk qëndron asnjë nga pretendimet e subjektit. Konkretisht, në vlerësimin e trupit gjykues të Komisionit, të gjitha veprimet e duhura hetimore janë kryer në mënyrë ezauruese, në funksion të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për të thirrur një dëshmitar, se kryerja e një veprimi hetimor dhe analiza e provave është në vlerësim të trupit gjykues e përbën një reflektim të provave të administruara në barrën e provës së dërguar. Trupi gjykues vlerësoi po ashtu se raporti i dërguar subjektit ishte në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues ka specifikuar që vendimi për të përfunduar hetimin

mbi kriterin e pasurisë është vendim kolegjal. Trupi gjykues çmon se ushtrimi i detyrës funksionale dhe/ose mënyra e interpretimit dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi, nuk përbën paragjykim dhe cenim të paanësisë së trupit gjykues dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përbëjë shkak për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues.

12.3. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i subjektit është i pabazuar dhe vendimi i Komisionit është i drejtë. Në këtë konkluzion, trupi gjykues thekson që vendimi i Komisionit për të mos pranuar kërkesën e subjektit për përjashtim të relatores së çështjes, nuk rezulton të jetë marrë në kundërshtim me parimet e paanësisë dhe objektivitetit në gjykim. Për më tepër, nga aktet në fashikull, rezulton që opinioni i Vëzhguesit Ndërkombëtar përbën një përmbledhje të çfarë duhet të arsyetojë Komisioni në përgjigje të argumenteve të subjektit të rivlerësimit për procesin e rregullt ligjor, sipas standardeve kushtetuese dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, bazuar në sa relatorja e çështjes ka parashtruar për të shteruar faktin që nuk ka pasur një ndryshim të rezultateve të hetimit administrativ për sa u shpjegua nga subjekti. Në paragrafët 27 deri 27.7 të vendimit, Komisioni ka shtjelluar se qëndrimi i relatores në asnjë rast nuk përbën një paragjykim në kushtet kur subjekti ka ushtruar të drejtën për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore, dhe parashtruar prova të reja që përbëjnë mundësinë ligjore për të paraqitur edhe prova që nuk janë paraqitur gjatë fazës së hetimit administrativ.

12.4. Komisioni ka sjellë në vëmendje që konkludimi nga trupi gjykues mbi përfundimin e hetimeve vetëm për një kriter, është vendosur në mënyrë kolegjiale dhe unanime. Nga ana tjetër, sipas Komisionit, mundësia për të rihapur hetimin duke konkluduar rivlerësimin mbi të tria kriteret, ekzistonte edhe pas shqyrtimit të prapësimeve, shpjegimeve, dokumenteve shoqëruese dhe përgjigjeve të subjektit gjatë hetimit dhe në seancë dëgjimore. Përfundimi i procesit të rivlerësimit vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar për kriterin e figurës apo të vlerësimit profesional.

- 13.** Subjekti parashtron që *vendimi për rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e relatores është marrë mbi bazën e një prove të panjohur nga ligji – komunikimi telefonik i trupit gjykues me relatorin e çështjes*. Kjo provë, e marrë në kundërshtim me nenin 11 të Kodit të Procedurës Civile, e bën procesin vendimmarrës të paligjshëm. Më tej, subjekti pretendon se nuk i është vënë në dispozicion, sipas kërkesës së tij, transkriptimi i bisedës telefonike, sepse transkripti nuk ekziston.

13.1. Sa u përket pretendimeve të subjektit për peshën procedurale të komunikimit telefonik mes Komisionit dhe relatores dhe transkriptimin e bisedës, nga aktet në dosje rezulton që vendimi për rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e relatores së çështjes i është njoftuar subjektit të rivlerësimit, më datë 19.06.2019 [konfirmuar marrja nga subjekti më datë 20.06.2019]. Më datë 28.06.2019, subjekti ka kërkuar të gjitha aktet që kanë shërbyer gjatë seancës gjyqësore në të cilën është vendosur për këtë kërkesë të tij, përfshirë: parashtrimet e relatores, transkriptimin e bisedës telefonike të kryer nga trupa gjykuese me relatorin në funksion të shqyrtimit të kërkesës së subjektit për përjashtimin e saj dhe çdo material tjetër që gjendet në dosjen për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e relatores. Komisioni ka plotësuar këtë kërkesë të subjektit, datë 02.07.2019 [me shkresën nr. {***} prot.].

Më datë 04.07.2019, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar sërish transkriptimin e bisedës telefonike. Sipas subjektit, meqenëse biseda telefonike është një provë e panjohur nga ligji, ajo nuk mund të përbëjë mbështetje për vendimin apo provë sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile. Pavarësisht se e konteston në parim këtë element, subjekti ka kërkuar përmbajtjen e bisedës telefonike, informacion për orën e fillimit e të mbarimit dhe të numrave të telefonit që janë përdorur pasi, sipas tij, përbëjnë të dhëna të nevojshme për të realizuar mbrojtjen. Subjekti po ashtu ka kontestuar edhe procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 19.06.2019 për

parregullsi në mungesën e nënshkrimit dhe mbajtjes nga sekretari i seancës, që bie ndesh me nenet 77 dhe 118 të Kodit të Procedurës Civile. Mungon ora e fillimit të seancës që përbën element me rëndësi thelbësore, sipas subjektit. Në procesverbalin e seancës të datës 19.06.2019, nuk referohet biseda telefonike e bërë mes trupit gjykues dhe relatores, znj. P., provë që sipas subjektit është marrë jashtë procesit gjyqësor dhe e panjohur nga ligji procedural, në kundërshtim me nenet 10 dhe 11 të Kodit të Procedurës Civile. Komisioni, në përgjigjen e tij të mëtejshme, datë 17.07.2019, ka referuar përgjigjen e dërguar më parë me shkresën nr. {***}, datë 02.07.2019.

13.2. Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që neni 75, paragrafi 5 i Kodit të Procedurës Civile parashikon që “[...] gjyqtari për të cilin kërkohet përjashtimi, ka të drejtë të paraqesë qëndrimin e tij me shkrim në lidhje me këtë kërkesë”. Së pari, kjo dispozitë parashikon një të drejtë dhe jo detyrim për anëtarin e trupit gjykues. Së dyti, nga aktet rezulton që këtë të drejtë relatorja e ka ushtruar me qëndrimin e saj me shkrim, i cili i është bërë i njohur edhe subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, transkripti i bisedës mes relatores dhe trupit gjykues, në dritën e kërkesave të dispozitës së sipërcituar, është dokument që tejkalon parashikimin ligjor të parashikuar nga neni 75 i Kodit të Procedurës Civile. Për më tepër, edhe në analizë të detyrimeve për transparencë të procesit, në kushtet kur kjo bisedë është konfirmuar me anë të procesverbalit – vënë në dispozicion subjektit pas kërkesës së parë drejtuar Komisionit – ky aspekt procedural konsiderohet i shteruar nga Komisioni. Për sa më sipër, biseda telefonike e kryer përbën një zgjedhje të trupit gjykues që do të shqyrtonte kërkesën e subjektit për përjashtimin e relatores, teorikisht dhe ligjërisht të panevojshme në kushtet kur vendimi i trupit gjykues për rrëzimin e kërkesës është mbështetur në parashtrime dhe provat e administruara; për pasojë, në asnjë rast biseda telefonike apo fakti që ajo është dokumentuar në ndonjë formë, dhe i është bërë e njohur subjektit, nuk mund të përbëjë cenim të procesit të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, edhe procesverbali i mbledhjes së trupës gjykuese të Komisionit më datë 19.06.2019, në kushtet kur vetë biseda nuk përbënte detyrim ligjor, nuk mund të argumentohet se cenon procedurën e ndjekur apo të drejtat procedurale të subjektit për shkak se në të nuk është shënuar ora e nisjes, apo mungon nënshkrimi i sekretarit të seancës. Ndërkohë, akti rezulton të jetë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues konstaton se vendimi i Komisionit për rrëzimin e kërkesës së subjektit për përjashtimin e komisioneres relatores, nuk është bazuar mbi bisedën telefonike, por mbi dokumente ligjore të administruara dhe se biseda është një burim shtesë për qëndrimin e relatores, por jo determinuese në vendimin e trupës gjykuese.

- 14.** *Subjekti i rivlerësimit pretendon se garancitë e procesit të rregullt ligjor nuk ezaurohen në seancë publike; ato mbulojnë të gjitha hallkat procedurale të hetimit, mbylljen e tij, dërgimin rezultateve të hetimit etj. Vota e dy anëtarëve të tjerë nuk është parashikuar në ligj si mënyrë për të kapërcyer çështjet e ngritura në kërkesën për përjashtim të bazuar në shkaqe njëanshmërie të relatores. Një anëtar që gjendet në kushtet e përjashtimit nuk mund të vijojë të jetë pjesë e trupës, meqenëse dy anëtarët e tjerë mund të votojnë ndryshe. Largimi i një anëtari të dyshuar si i njëanshëm, është detyrim ligjor në përputhje me standardet e Konventës (neni 6 i KEDNj-së).*

14.1. Sa i përket këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se nga aktet në fashikull apo nga analiza e pretendimeve të subjektit në ankim, nuk evidentohen raste cenimi të parimeve të një procesi të rregullt ligjor për subjektin e rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit në Komision. Hetimi administrativ për subjektin e rivlerësimit ka zgjatur 10 muaj – nga data 7 shtator 2018 kur është dërguar pyetësori i parë standard e deri në 11 korrik 2019 – kur është zhvilluar seanca dëgjimore. Komisioni i ka vënë në dispozicion subjektit kohën e kërkuar prej tij për t’iu përgjigjur pyetësorit të datës 07.12.2018, duke e shtyrë afatin në dispozicion nga shtatë (7)

ditë deri më datë 31.12.2018, sipas kërkesës së subjektit. Subjekti u është përgjigjur pyetësorëve të tjerë, të dërguar më datë 24.01.2019 dhe 19.02.2019, brenda afatit 7-ditor, respektivisht më 30.01.2019 dhe 25.02.2019, dhe nuk rezultojnë të ketë ngritur pretendim për kohë të pamjaftueshme. Në vijim, Komisioni rezultojnë të ketë shtyrë afatin e paraqitjes së shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ deri më datë 10.06.2019, thuajse 30 ditë, sipas kërkesës së subjektit [përcjellë më datë 13.05.2019]. Më datë 14.05.2019, subjekti ka konfirmuar njohjen dhe marrjen e dokumentacionit fizik të dosjes së hetimit administrativ dhe ka deklaruar se nuk ka vërejtje në lidhje me dokumentacionin/materialet e tërhequra pranë Komisionit¹³. Po ashtu, gjatë seancës dëgjimore të datës 11.07.2019, subjektit të rivlerësimit i është dhënë mundësia dhe koha e nevojshme për të parashtruar argumentet dhe qëndrimin e tij mbi konstatimet dhe rezultatet e hetimit administrativ të arritura nga Komisioni dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të adresuara. Subjekti ka sjellë prova me shkrim dhe ngritur argumente në mbrojtje të tij, të cilat janë analizuar nga Komisioni – siç shtjellohet më poshtë – dhe i është dhënë mundësia të njihet me aktet e të japë komente e prapësime për to. Së fundmi, nuk rezultojnë që subjekti të ketë shprehur në asnjë çast gjatë procesit të hetimit administrativ kërkesë për të pranuar akte të tjera në cilësinë e provës [përveç kërkesës për thirrjen e dëshmitarit E. N. të arsyetuar në paragrafët 15.1 - 15.3 më poshtë] apo të ketë potencuar shqetësime për pamundësinë për të kryer mbrojtjen e tij, përveç sa argumentuar në paragrafin 11.1 të këtij vendimi, lidhur me përgatitjen për në seancë dëgjimore.

14.2. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk qëndron. Procedura e kryer në Komision ka qenë në respektim të garancive kushtetuese që lidhen me procesin e rregullt, përfshirë parimin e kontradiktoritetit dhe atë të barazisë së armëve. Për këto arsye, edhe pretendimi i subjektit që seanca dëgjimore ishte *formalitet* është i pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vlerësim qëndron edhe për procedurën e ndjekur nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesës së subjektit për të përjashtuar relatorin e çështjes, për shkak se ka propozuar përfundimin e hetimit sipas nenit 4, pika 2¹⁴ e ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka krijuar trup gjykues të ndryshëm, ka shqyrtuar kërkesën e subjektit, ka dëgjuar relatorin dhe, mbështetur në dispozitat ligjore që zbatohen, ka marrë vendim për të rrëzuar kërkesën e subjektit. Trupi gjykues i Kolegjit nuk konstaton shkelje të garancive procedurale për proces të rregullt, në asnjërin prej këtyre hapave të ndjekur nga Komisioni. Për këto arsye, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

15. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se trupi gjykues ka refuzuar kërkesën e tij për thirrjen e një dëshmitari, në kundërshtim me nenin Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 49/9, nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 183 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas subjektit, Komisioni duhet të dispononte me vendim të ndërmjetëm, edhe kryesisht mbi kërkesat e subjektit të rivlerësimit lidhur me marrjen e provave që janë kërkuar pas kalimit të barrës së provës. Në kundërshtim me kërkesat e neni 231 të Kodit të Procedurës Civile, relatorja ka përmbysur standardin e procesit të të provuarit, ka tentuar të kundërshtojë nëpërmjet pyetjes së dëshmitarit provën me shkresë, të cilin ligji e kërkon për vlefshmërinë e veprimit juridik apo provimin e tij.*

15.1. Ky pretendim i subjektit të rivlerësimit referohet në kërkesën e tij për të thirrur si dëshmitar përfaqësuesin e shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, z. E. N. Nga dokumentacioni i dosjes gjyqësore, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se më datë 25.01.2019, Komisioni,

¹³Ky dokumentacion rezultojnë të jetë i njëjtë me dokumentacionin e përmbajtur në dosjet që iu vunë në dispozicion subjektit, sipas inventarit përkatës bashkëngjitur deklaratës.

¹⁴Neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon që: “[...] 2. Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave [...]”.

nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., i është drejtuar me *kërkesë për t'u paraqitur* shoqërisë “{***}” ShPK, me qëllim analizën e saktë të marrëdhënies së kësaj shoqërie me dy individë, A. M. dhe B. M., përkatësisht vëllai dhe babai i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës [pronarë të truallit] në kontratën e sipërmarrjes të vitit 2011¹⁵ dhe anekset e saj, duke çmuar të nevojshme dhënien e dëshmisë nga përfaqësuesi i shoqërisë, në bazë të nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 84/2016¹⁶, më datë 31.01.2019, ora 11:00. Me anë të komunikimit elektronik (*e-mail*) të datës 31.01.2019, Komisioni i ka shkruar sërish shoqërisë “{***}” ShPK, për ta informuar se të dhënat e kërkuara nga shoqëria janë të një natyre juridike dhe që kërkojnë njohuri të shtuara në lidhje me fakte e rrethana që kanë ndodhur në vitin 2011. Rezulton që z. N., përfaqësuesi ligjor, ka deleguar të paraqitet në Komision një punonjëse e cila nuk kishte dijeni për ngjarje të vitit 2011, kryente detyrën e juristes dhe kishte vetëm nëntë (muaj) që ishte punësuar pranë këtij personi juridik. Në të njëjtin komunikim (*email*), Komisioni kërkoi paraqitjen e një përfaqësuesi të shoqërisë që ka qenë i punësuar atje në vitin 2011 që të japë shpjegime mbi ndërtimin e bërë në këtë vit në pronën e familjes M. Komisioni kërkoi edhe aktin e kolaudimit të objektit të ndërtuar, si dhe raportin përfundimtar të kontrollit tatimor për këtë objekt. Më datë 05.02.2019, administratori i subjektit “{***}” ShPK, z. E. N., ka autorizuar një punonjëse tjetër [znj. N. K., ekonomiste-financiare e shoqërisë] për të dhënë dëshminë në kuadrin e analizës së marrëdhënies juridike mes shoqërisë dhe z. B. dhe A. M. Dëshmia e të dërguarës së z. N. për marrëdhënien juridike me familjarët e subjektit, është pjesë e fashikullit të Komisionit¹⁷.

15.2. Në kushtet kur Komisioni i është drejtuar dy herë shoqërisë “{***}” ShPK për të dërguar një përfaqësues, për të dhënë informacion mbi marrëdhëniet kontraktuale mes babait dhe vëllait të subjektit dhe kësaj shoqërie, trupi gjykues vlerëson se kërkesa e subjektit për të thirrur dëshmitar administratorin e shoqërisë, z. E. N., konsiderohet e ezauruar, pasi në të dyja rastet përfaqësueset e dërguara pranë Komisionit janë autorizuar nga ai vetë. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

15.3. Trupi gjykues i Kolegjit vëren që pretendimi i subjektit se Komisioni ka shkelur dispozitën e nenit 231 të Kodit të Procedurës Civile¹⁸, meqenëse “relatorja ka tentuar të kundërshtojë nëpërmjet pyetjes së dëshmitarit provën me shkresë, të cilin ligji e kërkon për vlefshmërinë e veprimit juridik apo provimin e tij”, është i pabazuar në fakte dhe në ligj. Përpos sa më sipër, bazuar në pikën 4 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 49, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka të drejtë të intervistojë individë dhe të mbledhë deklaratat nga dëshmitarë, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen. Nga aktet në fashikull, konkretisht, nga pyetjet të cilat i janë drejtuar përfaqësueses së shoqërisë, nuk rezulton që Komisioni ka kërkuar të përmbysë një provë shkresore – kontratën e sipërmarrjes dhe aneksin përkatës – me një dëshmi. Dhe nga arsyetimi i vendimit të Komisionit, nuk rezulton një analizë e tillë. Referuar pyetjeve drejtuar përfaqësueses së shoqërisë, sipas procesverbalit të datës 05.02.2019, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka hetuar lidhur me kontratat e nënshkruara me pronarët e truallit mbi të cilin kjo shoqëri ka kryer ndërtimin, mbi kontratën e sipërmarrjes me babain dhe vëllanë e subjektit të rivlerësimit, hetime lidhur me rrethana faktike e ligjore mbi aneksin e kontratës së sipërmarrjes,

¹⁵ Kontrata mban nr. {***} rep., nr. {***} kol., dhe është nënshkruar në datën 09.06.2011.

¹⁶ Neni 49, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon “[...] Deklarata e dhënë nga dëshmitari ose eksperti gjatë një procesi penal mund të përdoret në cilësinë e provës [...]”. Neni 49, pika 1 përcakton të drejtën e institucioneve të rivlerësimit të administrojnë prova dhe të thërrasin dëshmitarë.

¹⁷ Shih faqen 1018 të fashikullit 6 të përcjellë në Kolegji. Subjekti është njohur me këtë akt në datën 14.05.2019, siç rezulton nga inventari i akteve të marra prej tij po më këtë datë.

¹⁸ Neni 231 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: “[...] Prova me dëshmitarë lejohet në të gjitha rastet, përveç kur ligji për vlefshmërinë ose provimin e një veprimi juridik kërkon shkresë”.

përqindjen e përfitur nga këta të fundit në objektin e ndërtuar, e rrethana që lidhen me fitimin e shumës 30.000 euro prej subjektit. Nga aktet në fashikull, rezulton se Komisioni, në kuadër të hetimit administrativ, ka pasur komunikime të vazhdueshme [shkresore dhe elektronike] me shoqërinë “{***}” ShPK, në lidhje me këto çështje, duke administruar kështu informacion dhe dokumentacion¹⁹ nga shoqëria. Për më tepër, ky pretendim i subjektit është alogjik në kushtet kur thirrja e z. N. si dëshmitar, ka qenë edhe kërkesë e vetë subjektit të rivlerësimit dhe e ka potencuar mosthirrjen e këtij dëshmitari si ndër shkaqet e ankimit kundër vendimmarrjes së Komisionit. Më fjalë të tjera, subjekti tregon qasje me standard të dyfishtë dhe inkoherente. Ndërsa konteston thirrjen e një përfaqësuesi nga shoqëria e ndërtimit nga Komisioni për të shpjeguar rrethana të kontratës, meqenëse Komisioni nuk ka ngulmuar pas dy thirrjesh, e konsideron mospërpjekjen e mëtejshme shkelje të të drejtave të tij sipas nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe sipas dispozitave të ligjit nr. 84/2016 për provat. Parë në tërësi, për të gjitha arsyet e mësipërme, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

16. *Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka ftuar subjektin në seancë dëgjimore pa marrë në konsideratë provat e paraqitura nga subjekti, në kundërshtim me nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenet 45 dhe 55 të ligjit nr. 84/2016, nenet 48, 59, 87, pika 2, germa “ç” e Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në kundërshtim me pikat 10 dhe 11 të aktit “Hapat proceduralë të unifikuar për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykuese të Komisionit”. Në vlerësim të këtyre dispozitave, Komisioni duhet të njoftojë subjektin e rivlerësimit lidhur me rezultatin përfundimtar të hetimit, sipas nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative.*

16.1. Në analizë të këtij shkakut ankimor dhe të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore të përcaktuara në të, trupi gjykues në vijim të sa arsyetuar më sipër në këtë vendim, vlerëson se Komisioni ka vepruar në përputhje me parimet e procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit, si sanksionuar në nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës. Në zbatim të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, në kuadër të hetimit administrativ kryesisht, Komisioni ka kërkuar informacion pranë institucioneve/personave juridikë e fizikë, të cilët administrojnë dokumentacion të nevojshëm për realizimin e hetimit. Pas administrimit të shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit dhe dokumentacionit në mbështetje të tyre, në zbatim të nenit 55 të këtij ligji, ka ftuar subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti nuk provon se përse Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin 48²⁰ të Kodit të Procedurave Administrative, ndërkohë që ka vlerësuar me shkrim, me vendim të arsyetuar lidhur me kërkesën e paraqitur nga subjekti (i) për thirrjen në cilësinë e dëshmitarit të z. E. N., (ii) për kërkesën për përjashtimin e relatores së çështjes, si dhe me (iii) vendimin objekt shqyrtimi për procesin e rivlerësimit të subjektit Ilir Mustafaj. Bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, institucionet zbatojnë procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin për gjykatat administrative në ato raste kur procedurat nuk janë parashikuar në Kushtetutë apo në ligjin e posaçëm nr. 84/2016, ndërkohë që neni 59 i Kodit të Procedurave Administrative, me titull “Paraqitja e kërkesës”, nuk vlerësohet se mbështet pretendimin e subjektit dhe gjendet jorelevant. Ndërsa, sa i përket nenit 87 të këtij kodi, “Njoftimi dhe e drejta për t’u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar”, në pikën 2, germa “ç”, parashikohet se përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik njofton palën lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar, njoftimi përmban *provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës*. Lidhur me këtë parashikim, trupi gjykues, nga

¹⁹ Shkresë nr. {***} prot., datë 25.09.2018, “Kthim përgjigje, dhënie informacioni”. Shkresë nr. {***} prot., datë 16.10.2018, “Kthim përgjigje, dhënie informacioni”. Përgjigje e shoqërisë ndaj e-mail-it të Komisionit, administruar me nr. {***} prot., datë 18.02.2019.

²⁰ Neni 48 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon: “Organi publik, në çdo rast, është i detyruar të vlerësojë me shkrim mendimet dhe shpjegimet e të gjitha palëve të paraqitura, në përputhje me nenin 47 të këtij Kodi”.

shqyrtimi i procedurës së ndjekur nga Komisioni, konstaton se subjekti i rivlerësimit është njohur me rezultatet e hetimit administrativ [më datë 13.05.2019], me provat e administruara [më datë 14.05.2019], ka depozituar shpjegimet e tij dhe provat mbështetëse lidhur me këto rezultate [më datë 10.06.2019] dhe është ftuar në seancë dëgjimore [më datë 14.06.2019 dhe 11.07.2019], ka marrë njoftim të rregullt, ka qenë prezent në këto seanca dëgjimore dhe ka parashtruar gjithë argumentet e tij lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit. Në kuptim të “Hapave proceduralë të unifikuar”, të cilëve u referohet subjekti në ankim, trupi gjykues konstaton se pika 10 e tyre parashikon një procedurë të brendshme të trupit gjykues të Komisionit, ndërsa pika 11 rezulton e zbatuar plotësisht pasi subjekti është njoftuar për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancës dëgjimore, e zhvilluar jo më vonë se 15 ditë nga data e njoftimit, sipas parashikimit në këtë pikë. Sa më sipër, trupi gjykues gjen të pabazuar pretendimin e subjektit.

17. *Sipas subjektit, provat e grumbulluara nga Komisioni deri në përfundimin e hetimit administrativ, nuk provonin prezumimin ligjor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.* Rezultatet e hetimit administrativ nuk provonin që subjekti i rivlerësimit kishte pasuri të fshehura, deklarime të rreme apo burime të paligjshme të pasurisë, sipas parashikimit të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

17.1. Trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk është i bazuar. Së pari, subjekti i rivlerësimit nuk është shkarkuar nga detyra mbi bazën e rezultateve të hetimit administrativ. Ky hap procedural ka përbërë një analizë të akteve dhe shpjegimeve të subjektit, si pasojë e të cilave Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës sipas nenit 52²¹ të ligjit nr. 84/2016. Në këtë akt, Komisioni shprehimisht i ka treguar subjektit faktet për të cilat i ka kaluar barra e provës dhe është ftuar të sjellë shpjegime apo prova për të provuar të kundërtën. Nëpërmjet rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni ka njoftuar subjektin për një konkluzion *paraprak* për pamjaftueshmëri për të shlyer këstet e kredive bankare, për të përballuar shpenzimet jetike, për të kursyer likuiditete, krijuar gjendje në llogaritë bankare si dhe shpenzimet e tjera, duke rezultuar me bilanc negativ në vitin 2009. Nga analiza financiare janar - qershor 2011, rezulton që subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për të krijuar depozitën në shumën 10.300 euro, si dhe pamjaftueshmëri financiare për vitin 2013 për të shtuar gjendjen e likuiditeteve në fund të vitit në llogaritë bankare. Në zbatim të kalimit të barrës së provës, subjekti rezulton të ketë kthyer përgjigjen dhe shpjegimet e tij – protokolluar më datë 10.06.2019 – prej 48 fletësh dhe aktesh të tjera, analizuar më sipër në paragrafin 11.2. Konkluzioni për deklaram të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin, është dhënë nga Komisioni vetëm pas shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit mbi këto rezultate, dokumentacionit të depozituar në mbështetje të tyre, si dhe zhvillimit të seancës dëgjimore. Sa më sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

18. *Subjekti pretendon se Komisioni ka shkelur parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, duke trajtuar subjektin në mënyrë të diferencuar.* Për situata të njëjta objektive për subjekte të tjera rivlerësimi, Komisioni ka vendosur konfirmim në detyrë. Mbajtja e standardeve të njëjta në gjykim është rëndësishme, pasi në thelb është mbrojtja e parimit të sigurisë juridike. Standardet e shumëfishta që mbahen nga Komisioni për subjekte të ndryshme, e bëjnë subjektin të besojë “në subjektivizmin e vlerësimit të provave në dosjen e ankuesit²²”.

²¹ Neni 52, pika 2 parashikon që: “[...]2. Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën [...]”.

²² Faqe 15, paragrafi 41 i ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

18.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit Ilir Mustafaj ka potencuar ruajtjen e të njëjtit standard si për rastet e analoqe, edhe në seancën dëgjimore në Komision. Në vendim, Komisioni është shprehur se nuk ka konstatuar fakte apo rrethana të njëjta me ato që janë shqyrtuar në këtë vendim, në vendime të tjera, ku qëndrimi i Komisionit është argumentuar në specifikën e tij, si dhe ndryshe nga sa pretendon subjekti, qëndrimet e mbajtura në vendimet për subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni, nuk janë detyruese dhe nuk kushtëzojnë vlerësimet e trupit gjykues në çështjet që gjykon. Të njëjtin vlerësim subjekti e ka përcjellë nëpërmjet një letre të tij të mëhershme edhe në Kolegj. Konkretisht, më datë 09.04.2021, subjekti i rivlerësimit Ilir Mustafaj ka dërguar një shkresë në Kolegj, nëpërmjet së cilës ka kërkuar që në shqyrtimin e ankimit të tij kundër vendimit të Komisionit, Kolegji të mbante në konsideratë edhe një parashtrësë të tij të datës 2 shkurt 2021, dërguar misionit dhe përfaqësisë ndërkombëtare, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, si dhe vëzhguesve ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)²³.

18.2. Trupi gjykues, në trajtimin e këtij shkakut ankimor, sjell në vëmendje së pari se në morinë e parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, përcjellë në Kolegj në kohë të ndryshme, nuk rezulton ndonjë ilustrim i bazës mbi të cilën ai konkludon për standard të dyfishtë, pasi të gjitha aktet e sjella përbëjnë një ripërsëritje të shkaqeve të ankimit dhe lidhen me themelin e vendimmarrjes së Komisionit. Siç është shtjelluar hollësisht më sipër, në paragrafët që analizojnë rrëzimin e kërkesës së subjektit për të përjashtuar relacionin e çështjes për hetimin e një kriteri – në përputhje me nenin 4, pika 2 e ligjit – veprimet e kryera nga Komisioni për të cilat subjekti ankohet, lidhen me themelin e vlerësimit të provave dhe akteve. Analiza e trupit gjykues të Kolegjit, për secilin prej këtyre shkaqeve, shtjellohet më poshtë në detaj. Nga ana tjetër, objekt shqyrtimi i trupit gjykues në këtë çështje, është vendimi i Komisionit kundër të cilit ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Ilir Mustafaj. Për pasojë, edhe analiza ligjore që vijon do të konsistojë dhe do të jetë e kufizuar vetëm në kontrollin e vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi. Së fundmi, roli orientues i Kolegjit për mënyrën e zgjidhjes së çështjeve të ngjashme, në përputhje me përcaktimin e nenit 66, pika 2²⁴ e ligjit nr. 84/2016, kryhet nëpërmjet vetë vendimeve të Kolegjit – përfshirë edhe këtë vendim.

- 19.** Sipas subjektit, aplikimi i nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si shkak për shkarkimin e tij nga detyra, është i pamundur, pasi kjo dispozitë referon te neni 33 i këtij ligji. Në rastin e tij, nuk ekziston asnjë prej situatave ligjore që do të çonte drejt masës disiplinore të shkarkimit. Subjekti citon secilin prej përcaktimeve ligjore të nenit 33, pika 5²⁵ e ligjit nr. 84/2016.

19.1. Trupi gjykues i Kolegjit ka një jurisprudencë të konsiderueshme në drejtim të këtij përcaktimi ligjor. Edhe në rastin konkret, vlen të sillen në vëmendje se Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi ka konstatuar mungesën e burimeve të ligjshme për të “shlyer këstet e kredive bankare, për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzimet e tjera dhe për të krijuar likuiditete në llogaritë bankare²⁶” e, për pasojë, ka çmuar

²³ Parashtrësja e subjektit rezulton t'i jetë dërguar Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, ONM-së dhe drejtuesit të ONM-së, sikurse edhe secilit prej vëzhguesve në mënyrë nominale.

²⁴ Neni 66, pika 2, përcakton që: “[...] Kolegji i Apelit, në arsyetimin e vendimit të tij, orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme [...]”.

²⁵ Neni 33, pika 5, përcakton situatat ligjore që vijnë në vlerësimin e kriterit të pasurisë: “[...] a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti i interesit; b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) është kryer fshehje e pasurisë; ç) është kryer deklarim i rremë; d) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit”.

²⁶ Shih ndër të tjera faqet 29 dhe 30 të vendimit të Komisionit në:

<https://kpk.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Ilir-Mustafaj.pdf>.

se gjen vend aplikimi i nenit 61, pika 3, për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë. Mungesa e burimeve të ligjshme është një ndër pesë (5) situatat ligjore të parashikuara nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, e të cituara shprehimisht edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit në këtë shkak ankimi. Për këtë arsye, ky pretendim i subjektit nuk është i bazuar në fakte dhe në ligj, përveçse kontradiktor në vetvete. Analiza e këtij shkak ankimi në themel ndodhet në pjesën e arsyetimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë në paragrafët 29 e në vijim.

20. *Sipas subjektit, Komisioni duhet të kishte marrë në konsideratë konkluzionet ILDKPKI-së. Për rrjedhojë, Komisioni ka kryer një vlerësim jo të drejtë, të pabazuar në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit. Fakti që ILDKPKI-ja nuk ka marrë asnjë masë ndër vite ndaj subjektit, provon se raporti i Komisionit pasqyron konkluzione të pavërteta, është në kundërshtim me ligjin dhe bazohet në fakte të interpretuara qëllimisht në mënyrë të gabuar.*

20.1. Trupi gjykues sjell në vëmendje që dispozitat kushtetuese dhe ligjore i kanë përcaktuar qartë kompetencat e organeve të rivlerësimit në raport me vlerësimet e kryera nga organet e specializuara të përfshira në këtë proces. Fakti që ndaj subjektit nuk është marrë ndër vite asnjë masë nga ILDKPKI-ja apo që përfundimet e këtij organi kanë qenë pozitive në favor të subjektit, nuk ndikojnë në procesin e rivlerësimit. Komisioni arrin në vendimmarrje pas kryerjes së një hetimi të plotë dhe të pavarur. Ky fakt është trajtuar dhe në vendimin nr. 2/2017, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese (paragrafët 40 dhe 41), sipas të cilit:

[...] organet e tjera, të cilat janë të përfshira në procesin e rivlerësimit, kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale që kanë për qëllim të ndihmojnë institucionet kushtetuese në përmbushjen e mandatit të tyre. Në të gjitha rastet, autoriteti vendimmarrës mbetet tek organet e rivlerësimit (KPK-ja dhe KA-ja) të krijuara për këtë qëllim në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme. [...] bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr.84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.

20.2. Në zbatim të nenit 50 të ligjit nr. 84/2016 dhe në harmoni me interpretimin e kryer nga Gjykata Kushtetuese, përmendur më sipër, institucionet e rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin, kanë për detyrë të hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe gjatë hetimit administrativ mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike. Sipas së njëjtës dispozite, institucionet e rivlerësimit – por jo domosdoshmërisht institucionet e specializuara – kanë akses të gjerë në informacionin e ruajtur nga ente publike dhe private në drejtim të kontrollit të secilit prej kritereve të rivlerësimit, që përfshin dosjet personale, pasuritë, gjendjen gjyqësore, transaksionet bankare, kalimin e kufirit dhe të tjera të dhëna, ndër të tjera. Këtij aksesit të institucioneve të rivlerësimit i korrespondon detyrimi i entiteteve publike dhe private për të vënë në dispozicion informacionin e disponuar brenda një afati të caktuar kohor. Ligji parashikon edhe pasoja, në rast mungese bashkëpunimi. Me fjalë të tjera, në ngritjen e procesit të rivlerësimit, ligjvënësi i ka kushtuar kujdes të veçantë rëndësisë së hetimit nga institucionet e rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin, për të siguruar saktësinë e informacionit dhe për të garantuar të drejtat e subjekteve të rivlerësimit në funksion të misionit të procesit – kthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Sa më sipër, zbatuar në rrethanat e hetimit administrativ, parashikohet që Komisioni ka tagrin që pavarësisht rezultateve të hetimit të kryer nga autoritetet e pavarura, të kryejë verifikime dhe hetime të mëtejshme për të vërtetuar çdo indicie apo të dhënë që rezulton nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit. Nga analiza e akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se veprimet e

kryera nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit kanë qenë në përputhje me përcaktimet kushtetuese dhe ato ligjore. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

21. *Në interpretimin e subjektit të rivlerësimit, neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, kërkon që shkarkimi nga detyra të bazohet në plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të papërshtatshmërisë. Ndryshe nga parashikimi i pikave 1 dhe 2 të nenit 61 të ligjit, të cilat parashikojnë shkak shkarkimi më vete, përkatësisht për kriterin e pasurisë apo figurës, ndërsa pika 3 e nenit 61 lidhet njëkohësisht me dy kriteret.*

21.1. Kolegji tashmë ka një qëndrim të konsoliduar dhe shtjelluar në detaj në jurisprudencën²⁷ e tij, për faktin që vlerësimi mund të kryhet edhe mbi bazën e një kriteri, sipas përcaktimit të shprehur të nenit 4, pika 2 [shtjelluar edhe më sipër në paragrafin 8 e nënpjesët e tij] si dhe mbi zërthimin e konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm, përcaktuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, formulimi i të cilit për deklarimin e pamjaftueshëm të pasurisë konkretizon përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Prosesi i vlerësimit të kriterit të pasurisë zërthehet në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat përcaktojnë parimet dhe mënyrën e verifikimit të përmbushjes së detyrimeve të subjektit të rivlerësimit për të kryer deklarim të saktë, për të provuar burimet e mjaftueshme financiare të ligjshme dhe mungesën e konfliktit të interesit. Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë në pronësi apo në përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, janë elemente përcaktuese për kontrollin e plotë dhe vlerësimin e drejtë të kriterit të pasurisë.

21.2. Së dyti, nga leximi logjik i ligjit, rezulton që legjislatori ka zgjedhur formulimin alternativ, duke u dhënë të njëjtën peshë shkeljeve për shkaqe të veçanta. Vërtetimi i secilit prej këtyre shkaqeve *autonome*, sipas Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit, shkon në favor të prezumimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, rregullohet në një nen të posaçëm të Aneksit të Kushtetutës, sikurse neni Dh, dhe formulimi i pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 për deklarimin e pamjaftueshëm të kontrollit të figurës zërthen pikërisht përcaktimet e këtij neni. Pavarësisht se deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë dhe figurës janë përmbledhur në normimin ligjor të pikës 3 të nenit 61, bazuar në përcaktimin e qartë që jep Aneksi i Kushtetutës për këto dy kritere, nuk mund të pretendohet se aplikimi i tyre duhet të interpretohet në mënyrë kumulative. Në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, këto dy kritere nuk kërkojnë *doemos* praninë e njëra-tjetrës për t'u vërtetuar deklarimi i pamjaftueshëm. Kjo do të thotë se subjektet e rivlerësimit duhet të shpjegojnë bindshëm se nuk gjenden në kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme, nuk kanë kontakte të papërshtatshme, nuk kanë kryer deklarim të pamjaftueshëm të vlerësimit të pasurisë, nuk kanë kryer deklarim të pamjaftueshëm të kontrollit të figurës, janë të aftë profesionalisht, dhe që me sjelljet dhe veprimet e tyre nuk kanë cenuar besimin e publikut të drejtësisë. Për rrjedhojë, shkeljet e dispozitave që lidhen me deklarimin e pamjaftueshëm të pasurisë sipas ligjit kanë të njëjtën peshë, sikurse shkeljet për kriteret e tjera të parashikuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, ky pretendim i subjektit është i pabazuar.

22. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni në vendime të ndryshme ka mbajtur standarde të ndryshme të analizës dhe interpretimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke cenuar parimin e barazisë para ligjit të subjekteve të rivlerësimit. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i referohet vendimit nr. 46, datë 24.07.2018 të Komisionit, në paragrafin e dytë, faqe 11. Sipas kësaj reference, subjekti potencon që në rivlerësimin e tij, Komisioni ka konkluduar*

²⁷Shih vendimet nr. 8, datë 16.04.2019, paragrafi 79; nr. 10, datë 19.11.2018, paragrafi 65; nr. 3, datë 26.01.2021, paragrafi 17; nr. 4, datë 9.02.2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

në mënyrë të gabuar dhe të paargumentuar për deklaram të pasaktë dhe, për pasojë, ka cenuar standardin e nenit D të Kushtetutës, pa vlerësuar provat e paraqitura nga subjekti dhe as shpjegimet e tij gjatë hetimit.

22.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren së pari, që vendimi i referuar nga subjekti, që i përket subjektit të rivlerësimit Xh. Z., i është nënshtruar juridiksionit kontrollues të Kolegjit dhe është ndryshuar²⁸. Siç shtjellohet edhe më sipër në paragrafin 18.2, trupi gjykues sjell në vëmendje se funksioni orientues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, mbështetur në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, kryhet nëpërmjet vendimeve të arsyetuara. Në kushtet kur ky vendim i referuar nga subjekti i është nënshtruar kontrollit të Kolegjit dhe është ndryshuar, ky aspekt i vendimmarrjes së Komisionit për vendimin e sjellë në vëmendje konsiderohet i kryer.

22.2. Përpos sa më sipër, sjellim në vëmendje se në vendimin objekt shqyrtimi, që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit Ilir Mustafaj, nga aktet në fashikull rezulton që Komisioni ka arritur në konkluzionin që subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë *pas analizimit të provave* të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni ka arritur në një konkluzion të ndryshëm nga sa ka kërkuar subjekti i rivlerësimit, fakt që bie ndesh me sa pretendon subjekti. Ndërsa analiza e arsytimit të Komisionit për secilin prej konkluzioneve të kundërshtuara shtjellohet në vijim, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë që shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat e depozituara prej tij janë shtjelluar gjerësisht përgjatë gjithë arsytimit të vendimit përfundimtar²⁹ objekt ankimi. Konkretisht, nga një lexim i thjeshtë i vendimit të Komisionit, del qartë analiza e qëndrimit të subjektit për secilin element të vlerësimit pasuror. Në përmbledhje të këtyre fakteve, trupi gjykues vëren që pretendimi i subjektit se Komisioni nuk ka pranuar provat e shpjegimet e tij pa arsyetuar, është i pabazuar.

B. *Vlerësimi i Kolegjit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe shkaqet e ankimit*

- 23.** Mbështetur në aktet shkresore administruar në dosjen gjyqësore, në përgjigje të shkaqeve ankimore parashtuar nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, trupi gjykues kreu kontrollin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit Ilir Mustafaj, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016. Në konkluzion, siç shtjellohet edhe më poshtë, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi që ankimi i subjektit të rivlerësimit ishte i pabazuar, ndërsa vendimi i Komisionit duhej të lihej në fuqi. Më poshtë, arsytimi për secilin shkak ankimi të parashtuar nga subjekti.

*I. Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 121 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë*

- 24.** Me vendimin objekt shqyrtimi, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij kanë pasur pamjaftueshmëri financiare në vlerën 1.792.279 lekë për blerjen e tokës dhe ndërtimin e katit të parë të ndërtesës, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament banimi të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, ku banon aktualisht subjekti, deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*.
- 25.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion të Komisionit, pasi nuk është në përputhje me provat e administruara gjatë hetimit administrativ, për shkak se nuk është përlllogaritur drejt

²⁸ Shih: http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh_Zaganjori-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-paralel.pdf.

²⁹ Si shembull, trupi gjykues konstaton seksionin I/b, faqe 9, II/b, faqe 11, III/b, faqe 15 -16, IV, faqe 18-19, faqe 20 [së bashku me analizën e provave të sjella nga subjekti], seksionin “Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni [mungon numërtimi], faqe 21-22, faqe 23-24 për sa i përket pamjaftueshmërisë financiare në datën 10.06.2011, faqen 26 ku shtjellohen aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit për to, e faqet 28 e 29.

vlera e tokës së paguar realisht nga babai i tij, si dhe padrejtësisht nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat për të cilat subjekti paraqiti prova të mjaftueshme për të provuar ekzistencën dhe ligjshmërinë e tyre.

25.1. Nga aktet në fashikull, rezulton se pasuria apartament banimi është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* me sipërfaqe 121 m², e regjistruar në ZRPP, fituar me kontratën e kalimit të kredisë dhe premtim shitjes [me nr. {***} rep., nr. {***} kol.], datë 20.06.2006, në vlerën 54.660 euro, mbi bazën e kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.07.2004. Kontrata përfundimtare është bërë më datë 19.09.2007 [me nr. {***} rep., nr. {***} kol.], në vlerën 46.000 euro. Ndryshimi i vlerës është “për shkak të sipërfaqes më të vogël dhe për shkak të punimeve të pabëra [...]”. Si burim krijimi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *kreditë në vlerën 40.000 euro*, të marrë në dt. 19.07.2006, në Bankën Emporiki-Shqipëri ShA dhe 7.000 euro detyrim ndaj personave të tretë. Kjo mënyrë deklarimi rezulton e njëjtë me atë të cituar në deklaratën e interesave privatë periodikë 2006 (DIPPV).

25.2. Nga aktet në fashikull, rezulton që më datë 19.07.2006, Banka Emporiki – Shqipëri ShA i ka akorduar subjektit të rivlerësimit huan³⁰ në shumën 40.000 euro (në cilësinë e huamarrësit dhe dorëzanësit L. M./bashkëshortja), për financimin e blerjes së “një apartamenti [...] në përputhje me kontratën kalim kredie dhe premtim shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.06.2006”. Kredia është disbursuar më 01.08.2006³¹.

25.3. Kjo kredi është deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike vjetore për çdo vit nga 2006 e në vijim, së bashku me vlerën e shlyer/detyrimin e mbetur. Në deklaratën periodike për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e plotë të saj nëpërmjet *marrjes* së shumës 30.000 euro nga Shoqëria “{***}” ShPK, për llogari të kontratës së sipërmarrjes së dt. 09.06.2011 dhe aneks kontratës me të njëjtën datë “[...] që i bashkëngjitet kësaj kontrate. [...] 6.100 euro nga kursimet [...]”. Në deklaratën e pasurisë [*vetting*], subjekti ka deklaruar që kredia është shlyer më dt. 05.07.2006³², ndërsa vlera 30.000 euro është paguar nga shoqëria “{***}” ShPK ({***} ShPK) për llogari të kontratës së sipërmarrjes³³, realizuar midis shoqërisë ndërtuese dhe babait e vëllait të subjektit më 09.06.2011. Subjekti ka specifikuar që babai e vëllai ishin pronarët e truallit mbi të cilin është kryer ndërtimi e si rrjedhojë e kontratës në fjalë, kanë përfituar 851 m² sipërfaqe ndërtuese, një vend parkimi dhe një njësi tregtare në këmbim të sipërfaqes së tokës prej 332 m² në {***} dhe një banesë të ngritur në tokën e blerë më dt. 14.11.1998. Shuma 30.000 euro, përfituar nga subjekti, është konvertim për 50 m² sipërfaqe ndërtuese sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 09.06.2011, dhe aneks kontratës të së njëjtës datë.

25.4. Komisioni ka konstatuar në vendim, që përfitimi i shumës prej 30.000 eurosh, përdorur nga subjekti për të shlyer kreditë e marrë nga Emporiki Bank ShA, më 05.07.2011, nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën e të ardhurave të përfituara. Për këtë arsye, Komisioni ka konkluduar për deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën *vetting* “me pasojat e rastit”, por kjo shumë është poseduar realisht dhe përdorur nga subjekti³⁴. Nga ana tjetër, pavarësisht ekzistencës së disa mospërputhjeve apo problemeve në lidhje me këtë shumë, Komisioni ka konstatuar se kjo shumë është poseduar realisht dhe është përdorur nga subjekti,

³⁰ Kontratë huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.07.2006.

³¹ Me detajet përkatëse të sipërfaqes dhe adresës. Përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 15.08.2018, të Banka Amerikane e Investimeve ShA (ish-Banka Emporiki).

³² Gabim material i subjektit, pasi duhet të jetë 2011. Banka Amerikane e Investimeve ShA (ish-Banka Emporiki ShA), me shkresën nr. {***} prot., datë 15.08.2018, konfirmon se kjo kredi është mbyllur para afatit, më datë 05.07.2011, në vlerën 34.614,58 euro.

³³ Me nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 09.06.2011, nënshkruar mes “{***}” ShPK dhe A. e B. M.

³⁴ Paragrafi 73.11 i vendimit të Komisionit, faqe 17.

ka qenë me burim të ligjshëm financiar dhe që subjekti ka përfituar paraprakisht një pjesë të të drejtave pasurore që i përkisnin si trashëgimi nga nëna e vet “për nevoja të menjëhershme”.

25.5. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit për pesë (5) probleme lidhur me këtë shumë [30.000 euro] të pretenduar të përfituar: (i) probleme të mungesës së formës ligjore për sa i përket aneksit të kontratës së sipërmarrjes; (ii) mospërputhje mes deklarimeve të subjektit dhe përfaqësueses së shoqërisë mbi datat e akteve mbi bazën e të cilave është kryer pagesa prej 30.000 eurosh; (iii) mungesë e pagimit të tatimit për këtë shumë; (iv) shoqëria ndërtimore [{"***"} ShPK] ka deklaruar këtë shumë në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP) ditën kur subjekti ka dorëzuar deklaratën e pasurisë *vetting* në ILDKPKI, që krijon dyshime se deklarimi është kërkuar nga subjekti në funksion të procesit të rivlerësimit; dhe (v) subjekti nuk ka mbështetur me dokumentacion në deklaratën e pasurisë *vetting* përfitimin nga dëshmia e trashëgimisë së nënës, si bazë për përfitimin e shumës prej 30.000 eurosh.

25.6. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se e ka përfituar këtë shumë në cilësinë e *trashëgimitarit të nënës*, si dhe në saje të *kontributit të tij* në momentin e fitimit të pronësisë mbi truallin dhe ndërtimin e katit të parë të banesës. Sipas tij, këto pretendime provohen edhe nga kontrata përfundimtare e shkëmbimit e datës 05.05.2018, ndërmjet shoqërisë ndërtuese dhe pronarëve A. M. e B. M., si përfitues të vetëm të sipërfaqeve ndërtimore.

25.7. Nga analiza e pretendimeve të subjektit dhe akteve në fashikull, rezulton që pronarët A. M. dhe B. M. (vëllai dhe babai i subjektit përkatësisht) për truallin prej 332 m² dhe ndërtimin informal mbi të, sipas *kontratës së sipërmarrjes* me shoqërinë “{***}” ShPK, kanë rënë dakord të përfitojnë sipërfaqe ndërtimore, apartamentesh, dyqani dhe parkimi. Në kontratë, parashikohet se për banesën aktuale prej 300 m², pronari i truallit do të përfitonte një sipërfaqe kompensimi prej 150 m², nga e cila 50 m² do të konvertohen në 30.000 (tridhjetë mijë) euro, të cilët do të paguhen në tri këste.

25.7.i. Në aneksin e kontratës së sipërmarrjes, i cili është nënshkruar vetëm nga A. M. dhe B. M., ata deklarojnë se kanë rënë dakord që nga pjesa e cituar nga kjo kontratë, të përfitojë subjekti i rivlerësimit në vlerën prej 30.000 eurosh, që është konvertim i sipërfaqes 50 m² apartament. Vlen të theksohet se deklaruesit kanë marrë përsipër edhe të specifikojnë që përfituesi [subjekti i rivlerësimit], i cili nuk rezulton të ketë qenë i pranishëm apo palë nënshkruese, do ta përdorë këtë shumë “për shlyerjen e kredisë së marrë pranë Bankës Emporiki, më datë 14.07.2006”. Në të njëjtin akt, deklaruesit A. M. dhe B. M. shprehen që subjekti dhe z. D. M. (vëllai i subjektit) do të përfitojnë edhe sipërfaqe ndërtimore [...] nga sipërfaqja e mësipërme takuese [...] nga kontrata e shkëmbimit të truallit [...].

25.7.ii. Së fundmi, në aneks-kontratë, parashikohet edhe që: *Z. Ilir Mustafaj ka të drejtë të paraqitet personalisht pranë shoqërisë “{***}” ShPK, Tiranë, për tërheqjen e vlerës prej 30 000 eurosh, siç është përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 09.06.2011, sipas kësteve dhe afateve të përcaktuara në këtë kontratë [...].*

25.8. Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për sa i përket faktit që pretendimi për përfitimin nga trashëgimia nga nëna nuk është provuar me asnjë dokument. Me shpjegime mbi rezultatet e hetimit, subjekti ka shpjeguar se, sipas *Akt Ekspertimit Teknik* të datës 08.06.2019³⁵, nga kontrata e shkëmbimit atij i takon të përfitojë 114,25 m² dhe nga kjo pjesë që i takon nga trashëgimia, ai ka marrë vetëm ekuivalencën e 50 m², në vlerën 30.000 euro, shumë herë më e

³⁵ Përgatitur nga inxhinieri Xh. Gj., mbajtëse e licencës për vlerësimin e pasurive të paluajtshme me nr. {***}; e licencës për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi {***}; e licencës për projektim {***}.

vogël se vlera e pasurisë trashëgimore që i takon nga nëna e tij. Komisioni rezulton të ketë hetuar vetëm për sa i përket ligjshmërisë së fitimit të kësaj shume, nëpërmjet aneksit të kontratës së sipërmarrjes. Rezulton që në vitin 2011, kur subjekti ka përfituar shumën 30.000 euro, nuk ishte lëshuar dëshmia e trashëgimisë së të ndjerës M. M.

25.9. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se Komisioni ka pranuar të gjitha pretendimet e subjektit në lidhje me mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, përfshirë edhe pretendimin e subjektit se ka përfituar *paraprakisht një pjesë të të drejtave pasurore që i përkisnin si trashëgimi nga nëna e vet "për nevoja të menjëhershme"*. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësim, *vetting*, as në deklaratën e interesave privatë periodikë 2011, përfitimin e kësaj shume në cilësinë e trashëgimtarit të nënës.

- 26.** Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit për përfitime për shkak të *kontributit që ka pasur në momentin e fitimit të pronësisë mbi truallin dhe ndërtimin e katit të parë të banesës*, nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë në një gjendje familjare, me kryefamiljar babain B. M., deri më datë 25.07.2003. Subjekti ka deklaruar të ketë banuar në këtë banesë deri më dhjetor të vitit 2002, ka qenë anëtar i familjes në kohën e blerjes së tokës dhe ndërtimit të banesës, si dhe ka kontribuar financiarisht në blerjen e tokës dhe ndërtimin e katit të parë të banesës 2-katëshe. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit konsiderohet si kontribuues në blerjen e truallit dhe ndërtimin e katit të parë të shtëpisë, prej së cilës, në këmbim, ka përfituar shumën 30.000 euro, në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, babai dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit klasifikohen si persona të tjerë të lidhur. Në zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin ligjor të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të blerjes së tokës dhe ndërtimit të banesës, si pasuri të krijuara edhe me kontributin e tij, të cilat më pas kanë shërbyer si burim krijimi për shlyerjen e kredisë të financuar nga Emporiki Bank ShA, për apartamentin e ndodhur në rrugën "{***}", Tiranë.

26.1. Nga analiza financiare e kryer në Komision për periudhën 1996-2001 për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit dhe të familjarëve të tij për të blerë tokën arë me sipërfaqe 1000 m² në vitin 1998 dhe ndërtimin e katit të parë të banesës dykatëshe në vitet 1999-2001, rezultoi pamjaftueshmëri financiare në vlerën -1.792.279 lekë. Kjo balancë nuk përfshin shpenzimet jetike të familjes.

26.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se konkluzioni i Komisionit për pamjaftueshmëri në *blerjen e tokës dhe ndërtimin e katit të parë të ndërtesës* nuk është në përputhje me provat e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, pasi: i) nuk është përlllogaritur drejt vlera e tokës së paguar realisht nga babai i subjektit; si dhe ii) nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat për të cilat subjekti paraqiti prova të mjaftueshme për ekzistencën dhe ligjshmërinë e tyre.

26.3. Sipas subjektit në ankim, kontribuues në pagimin e vlerës për blerjen e tokës në vitin 1998, kanë qenë faktikisht dhe dy blerësit e parë, H. M. dhe Dh. L., në vlerat respektive 722.000 lekë (361 m² x 2.000 lekë/m²) dhe 614.000 lekë (307 m² x 2.000 lekë/m²). Babai i subjektit, nga vlera në total e blerjes së tokës, 2.000.000 lekë, ka kontribuar vetëm në masën 664.000 lekë (332 m² x 2.000 lekë/m²). Sipas subjektit, kontribuuesit H. M. dhe Dh. L. nuk kanë qenë të pranishëm në momentin e fitimit të pronësisë e nuk kanë nënshkruar aktin e blerjes së tokës. Nëpërmjet kontratës së shitblerjes së vitit 2000, palët kanë rregulluar pasojat e babai i subjektit u ka kaluar pjesën takuese reale kontribuuesve. Vlera prej 200.000 lekësh, e përcaktuar në kontratën e datës 12.09.2000, sipas *thënieve të familjarëve* të tij, ka qenë deklarative, thjesht si element i kontratës së shitjes.

26.4. Në mbështetje të sa më sipër, me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti ka depozituar tri (3) deklarata noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit nga dy blerësit dhe familjarë të tyre³⁶ që konfirmojnë sa pretendon subjekti, si dhe dokumentacion³⁷ me anë të të cilit kërkojnë të provohet mundësia financiare e z. H. M. dhe znj. Dh. L. në blerjen e tokës. Subjekti po ashtu ka parashtruar se mbështetja vetëm në kontratë nga Komisioni përbën veprime mekanike aritmetike, të cilat nuk vlerësojnë logjikisht vlerën e kontratës së shitjes së vitit 2000. Subjekti sjell në vëmendje po ashtu se nuk është logjike të shitet pasuria pas dy vjetëve 7 herë më lirë.

26.5. Nga aktet në fashikull, rezulton që toka arë 1000 m², ndodhur në fshatin {***}, Tiranë, është blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit kundrejt çmimit prej 2.000.000 (dy milionë) lekësh në datën 14.11.1998³⁸. Sipas dosjes së vetëdeklarimit të datës 29.08.2006³⁹, B. M. ka ndërtuar mbi sipërfaqen e tokës 332 m² në pronësi të A. M., objektin informal shtëpi banimi 2-katëshe, ndërtuar në vitin 1999, sipërfaqe ndërtimi 125 m², me adresë Njësia Administrative {***}, Tiranë. Më datë 12.09.2000, babai i subjektit i ka shitur pjesë të tokës vëllait të tij [H. M.], një individ me të cilin kanë marrëdhënie farefisnore [bashkëshortes së kushëririt të parë të nënës së subjektit, Dh. L.] dhe të birit [A. M.], respektivisht sipërfaqet 361 m², 302 m² dhe 332 m², përkatësisht në vlerën 200.000 lekë.

26.6. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vendimi i Komisionit për të bazuar analizën financiare për burimet e ligjshme në dokumentacion – sipas kontratave të shitjes të datës 14.11.1998 dhe asaj të datës 12.09.2000 – është i drejtë. Ky qëndrim përputhet me kërkesat e parashikuara nga neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016⁴⁰ dhe në harmoni me dispozitat e neneve 659, 660, 663 dhe 690 të Kodit Civil që përcaktojnë forcën provuese të tyre dhe natyrën konsensuale të kontratave të lidhura në formën e duhur mes palëve. Deklaratat noteriale të bëra në kuadër të procesit të rivlerësimit, të cilat nuk harmonizohen me ndonjë dokumentacion tjetër provues të kohës kur është kryer veprimi juridik, siç mund të kishte qenë, si shembull, një prokurorë përfaqësimi për B. M. nga z. H. M. dhe znj. Dh. L. në blerjen e tokës, nuk mund të kenë fuqinë provuese të kontratave të shitblerjes të nënshkruara në vitet 1998 dhe 2000, të cilat janë të vetmet dokumente që përcaktojnë vullnetin e pavesuar të palëve dhe kanë fuqinë e ligjit për palët.

- 27.** Subjekti parashtron që Komisioni duhet të kishte marrë në konsideratë edhe një kategori të ardhurash të tij dhe të familjes, sikurse: (i) të ardhura nga mësimdhënia në Fakultetin Ekonomik; (ii) të ardhura nga shitja e prodhimeve bujqësore e blegtorale, deklaruar në vlerën 350.000 lekë; (iii) të ardhurat e prindërve të subjektit për periudhën 1997-2001 si shitës ambulantë në tregun e fruta-perimeve në Tiranë, rreth 25.000 lekë në muaj; (iv) të ardhura të

³⁶ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.06.2019, e z. S. L., bashkëshorti i Dh. L., i cili deklaron se ai dhe bashkëshortja kanë paguar shumën 614.000 lekë për blerjen e tokës nga B. M.; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.12.2018, nga z. H. M. e Dh. L.; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.06.2019, e z. E. M. (djali i H. M.).

³⁷ Ky dokumentacion përbëhet nga: (i) kontratë shitblerjeje e shtëpisë së S. L. në fshatin {***}, Përmet, në vitin 1994, në vlerën 600 mijë lekë; (ii) vendim i Gjykatës së Rrethit Përmet, datë 01.08.1994, vërtetim fakti i pronësisë mbi shtëpinë e banimit në fshatin {***}; (iii) dokumentacion i lëshuar nga autoritetet gjermane për të ardhurat e realizuara nga E. M. për periudhën 1994 – 2000, kopje e certifikatës së martesës me T. L. dhe librezë kursimesh.

³⁸ Sipas dokumentacionit të përcjellë Komisionit më datë 18.02.2019 nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Kontratë shitblerjeje me nr. {***} rep., nr. {***} kol. PAGESA e kryer jashtë zyrës noteriale.

³⁹ Dërguar Komisionit nga Drejtoria e ALUIZNI-t Tiranë Rurale, datë 06.03.2019.

⁴⁰ Neni 49, pika 4 përcakton që: “[4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelitit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.

realizuara nga vëllai i subjektit të rivlerësimit [A. M.], nga puna si emigrant në Greqi për periudhën 1991 – 2000, në shumën 150.000 dhrahmi në muaj, si dhe kursimet rreth 70.000 (shtatëdhjetë mijë) dhrahmi në çdo muaj; (v) të ardhura nga interesa bankarë në shumën 263.893 lekë për periudhën janar 1998 – tetor 1998; (vi) të ardhura të tërhequra nga babai i subjektit të rivlerësimit gjatë viteve 1997 – 1998, transaksioni “cash” në shumën 420.871 lekë i investimit në letra me vlerë në Shoqatën e të Përndjekurve Politikë Vlorë; dhe (vii) të ardhura nga pensioni i babait për vitin 2001 në vlerën 53.304 lekë. Trupi gjykues i Kolegjit analizoi aktet në fashikull për secilin prej këtyre zërave të analizës financiare dhe vlerëson se qëndrimi i Komisionit ka qenë i bazuar. Më konkretisht, sa i përket secilit prej këtyre aspekteve, shtjellohet analiza si vijon.

27.1. Lidhur me pretendimin e subjektit se e ardhura në shumën 322.176 lekë nga Fakulteti Ekonomik për periudhën 1998-2001 duhet të konsiderohet në analizën financiare, nga aktet në fashikull rezulton se në përgjigjet e pyetësorit të datës 25.02.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kontributi i tij ka pasur për burim: (i) të ardhura nga paga si ndihmësgjyqtar dhe gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën shtator 1996 – dhjetor 2001 [në vlerën totale 1.406.445 lekë]; dhe (ii) të ardhura nga paga e bashkëshortes për vitin 2001. Subjekti ka deklaruar të njëjtat burime edhe në shpjegimet e rezultateve të hetimit ku shprehet:

[...] kontributi im për blerjen e tokës me sipërfaqe 332 m² dhe ndërtimit të katit të I-rë të banesës, ka qenë me të ardhurat nga paga ime për periudhën 1996-2001, dhe si ndihmësgjyqtar dhe gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (në vlerën totale 1.406.445 lekë) [...]. Po kështu edhe bashkëshortja ime ka kontribuar në ndërtimin e katit të I-rë të banesës për vitin 2001, në vlerën 60.000 lekë [...].

27.1.a. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka depozituar një shkresë nga Fakulteti i Ekonomisë [datë 30.05.2019]. Sipas kësaj shkrese, subjekti i rivlerësimit ka qenë pedagog i jashtëm i atij fakulteti në periudhën 1998 – 2005 dhe ka përfituar të ardhura bruto prej 65.100 lekësh për çdo vit. Siç vihet re nga shkresa, të ardhurat neto të përfituara nga subjekti për secilin vit, nuk specifikohen. Nga analizimi i akt vlerësimit kontabël⁴¹, rezulton që subjekti, nëpërmjet ekspertit, të ketë përlllogaritur të ardhurat e pretenduara si shumatore e të ardhurave bruto prej 65.100 lekësh/vit për vitet akademike 1998 – 2001 [total 260.400 lekë] me të ardhurat e subjektit nga mësimdhënia në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i {***}, me shumën 61.776 lekë. Ndërkohë që subjekti i pretendon këto të ardhura [322.176 lekë] vetëm nga Fakulteti Ekonomik.

27.1.b. Trupi gjykues vlerësoi që në analizën financiare të kryer në Kolegj, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, të përlllogaritë vlerën e kontributit prej 1.406.445 lekësh, nga paga e subjektit si ndihmësgjyqtar e gjyqtar, sipas specifikimit si burim krijimi të pasurive në analizë. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në përgjigje të pyetësorëve apo në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, të ardhurat nga mësimdhënia në Fakultetin Ekonomik si burim krijimi të kësaj pasurie [tokë “arë” me sipërfaqe 1.000 m² në 14 nëntor 1998, në {***}, Tiranë, në vlerën 2.000.000 lekë dhe ndërtimin e katit të parë të banesës prej muajit janar 1999 deri në fund të vitit 2001], këto të ardhura nuk u përlllogaritën si burim krijimi i kësaj pasurie. Rrethanat në të cilat ato u deklaruan për herë të parë si burim – në përfundim të procesit të hetimit administrativ – krijojnë bindjen që përbëjnë një përpjekje të subjektit për të shtuar burime të reja krijimi të pasurive gjatë procesit, në funksion të përmbysjes së një analize financiare negative.

⁴¹ Akt vlerësimi kontabël i përgatitur nga eksperti kontabël B. P. (NIPT {***}) më 07.06.2019.

27.2 Lidhur me kërkesën për të përfshirë në analizë të ardhurat nga shitja e prodhimeve bujqësore e blegtorale, si dhe gjësë së gjallë [deklaruar në vlerën 350.000 lekë], subjekti pretendon se deri në dhjetor të vitit 1996, kur prindërit janë larguar nga fshati [{***}, Ersekë], ata shitën pasuri të luajtshme, pjesë e ekonomisë së tyre bujqësore dhe blegtorale, në vlerën 350.000 lekë. Familja ka në pronësi [27.643 m²] tokë bujqësore. Shitja e produkteve bujqësore dhe e gjësë së gjallë është kryer “aty për aty” pa dokumentacion shoqëruar, në kushtet e diktuar nga koha, natyra dhe vendi i shitjes. Njësia administrative vendore përkatëse nuk ruan apo harton dokumentacion të kësaj natyre për asnjë familje bujqësore. Subjekti shprehet se prindërit e tij nuk kanë pasur detyrim dhe as mund të detyronin ish-komunën të mblidhte informacion për këtë fakt. Sipas ankimit, dokumentacioni që provonte të ardhurat e familjes M., nuk mund të merrej në rrugë tjetër përveç se nëpërmjet akteve që ka paraqitur subjekti në Komision – deklaratat noteriale. Të ardhurat janë të ligjshme, nuk lidhen me pagimin e detyrimit tatimor e, për pasojë, për të vlerësuar ligjshmërinë e të ardhurave të kësaj familjeje, Komisioni duhet të bazohet te përcaktimi kushtetues i nenit D, pika 3, fjalia e fundit: *elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.*

27.2.a. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit, subjekti ka depozituar në Komision deklaratat noteriale⁴² të katër individëve, të cilët deklarojnë se kanë blerë nga babai i subjektit mallra bujqësore e blegtorale dhe gjë të gjallë në vitin 1996, duke paguar në total shumën 350.000 lekë.

27.2.b. Në kushtet kur të ardhurat në shumën 350.000 lekë nuk u provuan, trupi gjykues, në përputhje me përcaktimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 – cituar më sipër – dhe jurisprudencës⁴³ së Kolegjit, vlerëson se aktet e sjella nga subjekti në mbështetje të këtij pretendimi, nuk u vlerësuan se kanë vlerë provuese e, për pasojë, kanë efekt deklarativ. Trupi gjykues vëren edhe që ky pretendim i subjektit nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën *vetting* apo në deklaratën e parë, atë të vitit 2003. Nga ana tjetër, edhe në rastin hipotetik, nëse do të përlloriteshin të ardhurat e familjes së prindërve me rastin e largimit nga fshati, nën dritën e rrethanave që lidhen me kontekstin dhe kohën kur pretendohet të jenë përfituar të ardhurat nga shitja, personat e lidhur gjithsesi rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme. Kjo analizë shtjellohet në vijim.

27.3. Subjekti i rivlerësimi kundërshton analizën financiare të Komisionit duke kërkuar të konsiderohen të ardhurat e prindërve për periudhën 1997-2001 si shitës ambulantë në tregun e fruta-perimeve. Gjatë procesit të hetimit administrativ dhe në ankim subjekti ka pretenduar të përlloriten si burim për blerjen e tokës [1000 m²] dhe ndërtimin e banesës edhe të ardhurat e realizuara nga prindërit në shumën 25.000 lekë në çdo muaj për këtë periudhë kohore, si shitës ambulantë pranë Drejtorisë së Policisë Tiranë.

27.3.a. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale të babait të tij [me datë 22.02.2019 [nr. {***} rep./kol.], si dhe disa deklarata noteriale të tjera⁴⁴ të

⁴² Deklaratë noteriale, datë 28.05.2019 [nr. {***} rep., nr. {***} kol.], e D. T., për blerjen në fund të vitit 1996, të njëzet krerëve dele nga B. M., në vlerën prej 120.000 lekësh; deklaratë noteriale, datë 28.05.2019 [nr. {***} rep., nr. {***} kol.], e D. M., për blerjen në fund të vitit 1996 nga B. M., të disa bagëtime në vlerën prej 140.000 lekë; deklaratë noteriale, datë 28.05.2019 [nr. {***} rep., nr. {***} kol.], e R. Ç., i cili deklaroi blerjen në vitin 1996 nga B. M. të produkteve bujqësore dhe mjete pune bujqësore në vlerën 40.000 lekë; deklaratë noteriale, datë 28.05.2019 [nr. {***} rep., nr. {***} kol.], e K. T., për blerjen e një kali në vitin 1996 nga B. M., në vlerën e 50.000 lekëve.

⁴³ Shih vendimet nr. 23/2020(JR), datë 25.09.2020, paragrafi 26.2; nr. 34/2019(JR), datë 02.12.2019, paragrafi 85.2, vendimi nr. 3/2021 (JR), datë 26.01.2021, paragrafi 57.

⁴⁴ Deklaratë noteriale, datë 30.05.2019 [nr. {***} rep., nr. {***} kol.], nga E. P., e cila deklaroi që në pronë të ndjerit, babait të saj A. P., shisnin fruta-perime prindërit e subjektit në periudhën e pretenduar nga subjekti; kopje dokumentacioni mbi praktikën gjyqësore me palë paditëse A. P., me objekt “Vërtetimi i faktit të dokumentit

lëshuara nga persona që kanë pasur marrëdhënie të ndryshme – klientë, kanë shitur së bashku me prindërit e subjektit ose kanë ruajtur në pronën e tyre mjetet që shërbenin për mbajtjen e produkteve. Për shkak të marrëdhënies së krijuar mes njërit prej këtyre individëve [A. P.] dhe prindërve të subjektit, në vitin 2002, subjekti rezulton të ketë hequr dorë nga gjykimi në një çështje ku ky person ishte palë.

27.3.b. Subjekti referon dispozitat e nenit 7 të ligjit nr. 7632, datë 04.11.1992⁴⁵, dhe ato të nenit 2, pika 4 e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, për të argumentuar se shitësit ambulantë, për shkak të përmasave të aktivitetit të tyre, nuk konsiderohen tregtarë dhe nuk i nënshtrohen këtij ligji. Për pasojë, argumenton subjekti, babai i tij nuk disponon aktualisht dokumentacion justifikues.

27.3.c. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues sjell në vëmendje që, ndërsa dispozitat ligjore të cituara nga subjekti në ankim, nuk e konsiderojnë veprimtarinë ekonomike të shitësit ambulant si veprimtari tregtare, dhe ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në nenin 8 të tij nuk parashikon në të ardhura të tatueshme të ardhurat si shitës ambulant, subjekti nuk ka provuar që prindërit e tij kanë krijuar të ardhurat e pretenduara në vlerën 300.000 lekë në vit [25.000 lekë çdo muaj]. Subjekti nuk arriti të provojë asnjë gjurmë të aktivitetit nëpërmjet pagimit të taksës së regjistrimit, apo taksës për zënie e vendit, në kuptim të nenit 7, “Taksat lokale”, të ligjit nr. 7777, datë 22.12.1993, “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 6, paragrafi II, “Taksat vendore”, i ligjit nr. 8435, datë 28.12.1998, “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe ligjeve të tjera të miratuara në vijim. Edhe kërkesa për dorëheqjen e sjellë nga subjekti, e cila u referohet marrëdhënieve mes familjes së subjektit dhe z. P., ndonëse ka një vlerë provuese për shkak të kohës kur është kryer, nuk përmban informacion relevant për sa u përket të ardhurave të pretenduara në sasinë e deklaruar.

27.3.ç. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje që edhe kërkesa e subjektit që Kolegji “të bëjë teste në treg për të parë konkretisht se sa të ardhura sigurojnë tregtarë të tillë”, është e pabazuar, sikurse është i pabazuar argumenti që në mungesë të të dhënave, duhet të pranohet i mirëqenë deklarimi i subjektit. Në procesin e rivlerësimit, barra e provës i përket subjektit të rivlerësimit⁴⁶. Për këto arsye, edhe ky pretendim i subjektit nuk u mor në konsideratë në analizën financiare të kryer në Kolegji, pasi u çmua se nuk e kapërcen nivelin deklarativ.

27.4. *Subjekti kundërshton mospërfshirjen në përllogaritjen e Komisionit të të ardhurave nga punësimi i vëllait të subjektit të rivlerësimit si emigrant në Greqi për periudhën 1991–2000. Nga analiza e dokumentacionit në fashikull, rezulton që më datë 16.01.2019 dhe 25.02.2019,*

*të falsifikuar”, për të cilin subjekti ka kërkuar heqjen dorë në bazë të nenit 72/ç të Kodit të Procedurës Civile, meqë kanë ekzistuar marrëdhënie midis familjes së subjektit dhe paditësit A. P.; deklaratë noteriale, datë 06.06.2019 [nr. {***} rep., nr. {***} kol.], e R. S., që deklaroi se prindërit e subjektit kanë punuar si shitës në tregun e fruta-perimeve nga viti 1997 e në vazhdim; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.06.2019, e K. E. e cila deklaroi të ketë punuar bashkë me prindërit e subjektit nga viti 1997 e në vazhdim si shitëse ambulante; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.06.2019, e shtetasve H. dhe N. Sh., që deklaroi në njëjtën gjë; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.06.2019, A. O., deklaroi se ka furnizuar me mall, bashkëlidh ekstraktin e shoqërisë “{***}” ShPK.*

⁴⁵ Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar.

⁴⁶ Neni 52 i Aneksit të Kushtetutës parashikon që: “[5]. Barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal”. Neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “[...] Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45 të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën”.

subjekti ka depozituar akte⁴⁷ për të provuar qëndrimin, punësimin dhe të ardhurat e ligjshme të vëllait të tij në Greqi në shumën 150.000 dhrahmi në muaj, si dhe kursimet rreth 70.000 (shtatëdhjetë mijë) dhrahmi në çdo muaj.⁴⁸

27.4.a. Nga analiza e akteve, trupi gjykues i Kolegjit, ashtu si edhe Komisioni, konstaton që dokumentacioni i sjellë nga subjekti i rivlerësimit provon të ardhura të përfituara nga vëllai i subjektit të rivlerësimit A. M., vetëm për një muaj – shkurt 1999 – ndërkohë që pjesa tjetër e të ardhurave të pretenduara dhe përlllogaritura nga eksperti kontabël në *akt vlerësimit kontabël*⁴⁹, depozituar nga subjekti me shpjegimet për rezultatet e hetimit administrativ, nuk provohet me dokumentacion justifikues ligjor. Me konsideratë jurisprudencën e Kolegjit⁵⁰, në analizën financiare të kryer në Kolegj, ashtu si dhe Komisioni, në përmbushje të kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, janë konsideruar vetëm të ardhurat që provohen me dokumentacion justifikues ligjor dhe për të cilat janë përmbushur detyrimet përkatëse tatimore në vendin e krijimit.

27.5. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk janë përfshirë në analizën financiare të kryer në Komision [1996-2001] të ardhurat nga interesa bankarë për periudhën janar–tetor 1998, në shumën 263.893 lekë, nga depozita 1.184.000 lekë, përfituar nga i ati nëpërmjet një vendimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të vitit 1997⁵¹. Sipas subjektit, informacioni nga Banka e Shqipërisë së bashku me aktin e ekspertimit kontabël duhet të kishin bindur Komisionin për të ardhurën e përfituar nga interesat. Këto të ardhura u përkasin 21 viteve më parë, në kushtet e informalitetit në Shqipëri që, për pasojë, e bëjnë kërkimin e dokumentacionit të plotë provues të paarsyeshëm. Përlllogaritjet nuk mund të kryhen thjesht në mënyrë mekanike, argumenton subjekti, duke theksuar që informaliteti është fakt i njohur botërisht. Në shpjegimet e rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar se kontributi i prindërve të tij konsiston dhe në të ardhurat e përfituara nga shuma monetare e përfituar nga vendimi i mësipërm dhe interesat deri në momentin e tërheqjes, në vlerën në total 1.625.893 lekë.*

27.5.a. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton që babai i subjektit [B. M.], më datë 31.12.1997 ka pasur gjendje në depozitë 1.362.000 lekë në Bankën e Kursimeve⁵², sot Raiffeisen Bank ShA. Së dyti, pas kërkesës së subjektit, Raiffeisen Bank, më datë 02.10.2018, ka konstatuar se nuk kanë gjetur dokumente të tjera që vërtetojnë lëvizjet e kësaj depozite për

⁴⁷ Vërtetim i datës 18.03.1998, i Zyrës së Punës {***} (Organizata e Punësimit të Fuqisë Punëtore), ku vërtetohet kërkesa për lëshimin e “Kartës së Lejes së Qëndrimit të Përkohshëm të të Huajit”; vërtetim nga Drejtoria e Sigurisë {***}, Athinë, datë 26.05.1998, sipas të cilit shtetasi i huaj, shqiptar, nuk u gjend i regjistruar në listën e të huajve të padëshirueshëm; Librezë Urdhrash Sigurimesh të të Punësuarve në Vepra Ndërtimi & Teknike (Instituti i Sigurimeve Shoqërore Dega {***}, Zyra e Ndërtimit), datë 7.3.1999, ku përcaktohen për muajin shkurt 1999, të ardhurat e A. M. kanë qenë në shumën 124.850 dhrahmi greke, ndërsa sipas kontratë ISSH {***}, dhurata ka qenë në shumën 31.212 dhrahmi. Në vijim, janë depozituar nëntë urdhra sigurimi. Më datë 25.02.2019, subjekti ka përcjellë deklaratën noteriale, datë 22.02.2019 [nr. {***} rep., nr. {***} kol.], nga A. dhe B. M.. Vëllai i subjektit deklaroi se çdo vit, në periudhën 1991 deri në korrik të vitit 2000, ka punuar në Athinë.

⁴⁸ A. M. deklaroi të ketë realizuar të ardhura nga pagë mujore 150.000 dhrahmi në muaj, prej të cilave është shpenzuar për jetesë dhe banim, duke mbetur një kursim prej thujse 50%, rreth 70.000 dhrahmi në muaj.

⁴⁹ Akt vlerësimi kontabël i përgatitur nga eksperti kontabël B.P. (NIPT {***}), më 07.06.2019.

⁵⁰ Shih vendimin nr. 4, datë 12.02.2019, paragrafi 37.2.2., vendimin nr. 6, datë 28.02.2019, paragrafi 20.12, vendimin nr. 23, datë 25.09.2020, paragrafi 26.3, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁵¹ Vendimi me nr. {***}, datë 27.06.1997, i Gjykatës së Rrethit Tiranë, në çështjen me paditës B. M. dhe të paditur kompaninë “{***}” ShPK, me objekt kthim shume. Gjykata ka vendosur detyrimin e shoqërisë “{***}” ShPK t’i kthejë paditësit B. M. shumën prej 1.184.000 lekësh. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. {***}, nr. {***} regj., datë 30.07.1997. Në bazë të vendimit më sipër, kreditori B. M. ka tërhequr më datë 31.07.1997 shumën gjithsej prej 1.184.000 lekësh, sipas fotokopjes së Qendrës së Informatizimit Financiar administruar në dosjen gjyqësore.

⁵² Shkresën nr. {***} prot., datë 22.02.2019, të Raiffeisen Bank ShA. Të njëjtat të dhëna janë konfirmuar edhe me shkresën “Kthim përgjigje” nr. {***} prot., datë 27.05.2019, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe të atit.

periudhën në vazhdim – prej datës 31.12.1997 e më tej – në lidhje me ndonjë shumë të depozituar nga babai i subjektit të rivlerësimit pranë asaj banke. Në vijim të shkresës, banka i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit një pasqyrë të normave të interesit për depozitat bankare, në monedhën lek, për periudhën 1997 – 1998. Nëse do të zbatoheshin këto norma interesi për shumën e specifikuar nga subjekti [1.362.000 lekë] për një depozitë kursimi tremujore, janar 1998 – tetor 1998, e ardhura nga interesat do të ishte 263.893 lekë, ndërsa vlera e kapitalit të investuar plus interesa në total, në shumën 1.625.893 lekë⁵³. Është kjo vlerë që, sipas subjektit, është tërhequr në datën e nënshkrimit të kontratës së blerjes së tokës në {***}, Tiranë.

27.5.b. Në përmbledhje të dokumentacionit të administruar⁵⁴, trupi gjykues i Kolegjit vëren që shuma 1.184.000 lekë, tërhequr më datë 31.07.1997, nga shoqëria “{***}” ShPK, rezulton të ketë qenë gjendje në ish-Bankën e Kursimeve më datë 31.12.1997 dhe teprica e depozitës në këtë bankë në këtë datë, përfshirë të ardhura nga interesat e kredituar në llogari, ka qenë në shumën **1.362.000 lekë**. Pretendimi i subjektit që gjendja e depozitës më datë 01.10.1998, ka qenë në shumën 1.625.893 lekë, nuk bazohet në dokument justifikues ligjor, por në përlllogaritjet sqaruese të bëra nga Raiffeisen Bank ShA për shumën sipas kërkesës të subjektit. Ndodhur në kushtet kur e ardhura e pretenduar nga interesat në shumën 263.893 lekë (1.625.893 lekë - 1.362.000 lekë), nuk provohet me dokumentacion justifikues ligjor, trupi gjykues, ashtu si dhe Komisioni, ka vlerësuar të mos e përfshijë në të ardhura të ligjshme në analizën financiare të kryer në Kolegj.

27.6. *Subjekti kërkon të përfshihen në të ardhura në dispozicion të familjes në vitet 1997 – 1998, shuma prej 420.871 lekësh, të tërhequra cash nga investimet në letra me vlerë, në Shoqatën e të Përndjekurve Politikë, Vlorë. Mandatin që provon përfitimin e babait nuk e disponon, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.* Subjekti pretendon se Komisioni kërkon dokumentacion provues shtesë, si mandate arkëtimi në kundërshtim me parashikimet kushtetuese dhe i referohet pamundësisë objektive për të poseduar dokumentacionin, parashikuar nga neni 32, pika 2⁵⁵ e ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit, ky dokumentacion nuk mund të merret në rrugë tjetër, përveç se të provohet me provat që tashmë i ka paraqitur, pasi babai nuk kishte detyrim ligjor të ruante dokumentacionin që provon tërheqjen e këtyre të ardhurave në atë kohë.

27.6.a. Nga aktet në fashikull, e konkretisht një aktmarrëveshje noteriale e datës 20.10.1995 dhe shtojca e datës 2.2.1996, përcjellë në Komision nga subjekti më datë 10.06.2019 me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, rezulton që disa ish të përndjekur politikë në Vlorë, përfitues të letrave me vlerë privatizimi, merrnin përsipër grumbullimin e letrave me vlerë nga të gjithë të përndjekurit politikë me qëllim blerjen e objekteve ish-pronë shtetërore në favor të poseduesve të tyre. Më pas, blerësit do të ishin anëtarë të shoqatës së të përndjekurve politikë “{***}” Vlorë, si dhe bashkëpronarë në objektin që do të blihej në varësi të vlerës së investuar.

⁵³ Raiffeisen Bank ShA, me shkresën “Kthim përgjigje” nr. {***} prot., datë 06.06.2019, sqaron se me kërkesë të subjektit, u përlllogaritën interesat e depozitës së kursimit në shumën 1.362.000 lekë, me afat 3-mujor, për periudhën nga data 31.12.1997 – 31.03.1998 dhe për periudhën deri më datë 01.10.1998, rezulton që gjendja e depozitës më datë 01.10.1998 të ishte 1.625.893 lekë.

⁵⁴ Konkretisht, shkresa nr. {***} prot., datë 25.02.2019, e Shoqërisë {***} dhe shkresat nr. {***} prot., datë 22.02.2019 dhe nr. {***} prot., datë 27.05.2019, të bankës Raiffeisen ShA.

⁵⁵ “[2.] Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor. [...]”

27.6.b. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka depozituar një urdhër-xhirim të datës 21.03.1996, me anë të të cilit urdhërohet Banka Kombëtare Tregtare, të debitojë një llogari të caktuar në emër të z. B. M. dhe të kreditojë një llogari tjetër me përshkrim “Shoqëria e të Përndjekurve Politikë “{***}”, Vlorë”, urdhër-xhirim i nënshkruar nga B. M. Nga ana tjetër, më datë 06.06.2019, Banka Raiffeisen ShA, dega Vlorë, ka informuar babanë e subjektit se: [...] emri i B. I. M. nuk figuron në inventarin e letrave me vlerë [...] dhe që banka nuk ka të dhëna dhe dokumente për veprimet e kryera me letrat me vlerë në ish-Bankën e Kursimeve në vitet 1997 – 1998, pasi ka kaluar afati i ruajtjes së tyre në arkiv.

27.6.c. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vëren që subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor tërheqjen në *cash* të shumës 420.871 lekë [pretenduar në dy pjesë, 250.000 lekë në vitin 1997 dhe 170.871 lekë në vitin 1998], pasi Raiffeisen Bank ShA nuk vërteton tërheqjen apo transaksionet për investim të letrave me vlerë në Shoqatën e të Përndjekurve Politikë “{***}”, Vlorë. Për këto arsye, këto të ardhura nuk u përfshinë në analizën financiare të kryer në Kolegj për periudhën 1996 – 2001.

27.7. Sipas subjektit, në analizën financiare të kryer, Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë padrejtësisht të ardhurat nga pensioni i babait të subjektit të rivlerësimit për vitin 2001, në vlerën 53.304 lekë. Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 19.03.2019 dhe vërtetimit nr. {***}, datë 26.06.2019, përcjellë Komisionit nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë, babai i subjektit të rivlerësimit B. M. rezultojnë të ketë realizuar të ardhura nga pensioni për periudhën 03.04.2001 – 31.12.2001 në shumën prej 53.304 lekë. Trupi gjykues, edhe pse e konsideron të drejtë pretendimin e subjektit për këtë të ardhur, vëren se analiza financiare e kryer në Kolegj, duke e përfshirë këtë të ardhur, sërish rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive objekt shqyrtimi me të ardhura të ligjshme.

- 28.** Për të provuar mundësinë financiare të subjektit dhe anëtarëve të familjes për të justifikuar me të ardhura nga burime financiare të ligjshme investimin në blerjen e tokës dhe ndërtimin e banesës, në Kolegj u krye analiza financiare në shqyrtim të shkaqeve të ankimit kundër konkluzionit të Komisionit për pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme të subjektit dhe familjes së tij në periudhën 1996 – 2001, në vlerën 1.792.279 lekë. Në ndryshim nga Komisioni, në referencë edhe të jurisprudencës⁵⁶ së Kolegjit, trupi gjykues e bazoi analizën financiare të ndërtimit të shtëpisë dykatëshe si investim të vitit 1999 — sipas vetëdeklarimit të babait të subjektit në formularin e vetëdeklarimit të datës 29.08.2006, referuar akteve të përcjella nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Ndërtimore Informale Aluizni-t Tiranë (ALUIZNI)⁵⁷. Komisioni rezultojnë të ketë zgjedhur të bazojë përlllogaritjen e ndërtimit të katit të parë të banesës në shpjegimet e subjektit gjatë procesit të hetimit administrativ, sipas të cilave koha e ndërtimit është zhvendosur nga subjekti dhe pranuar nga Komisioni në vitet 1999 – 2001. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, kati i parë është konsideruar i përfunduar në vitin 1999, ndërsa kati i dytë është përlllogaritur me gjysmën e kostos së ndërtimit, për arsye se nga fotografitë e depozituara në kuadër të vetëdeklarimit të vitit 2006, kati i dytë rezultojnë në gjendje karabina me kolona dhe soletë.

28.1. Për të përcaktuar koston e ndërtimit të shtëpisë [dykatëshe], trupi gjykues iu referua të dhënave zyrtare të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 214, datë 28.04.1999, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K” dhe vlerave të specifikuara

⁵⁶ Shih vendimin nr. 22, datë 16.09.2020, paragrafi 45, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁵⁷ Shkresa me nr. {***} prot., datë 06.03.2019.

nga faqja zyrtare e Entit Kombëtar të Banesave për vitin 1999. Në total, nga përlllogaritja e këtyre vlerave, kostoja e ndërtimit të banesës përlllogaritet në vlerën 3.756.187 lekë⁵⁸.

28.2 Rezultatet e analizës financiare të kryer në Kolegj treguan mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 3.548.069 lekë të kryefamiljarit B. M., subjektit dhe anëtarëve të tjerë të familjes për të kryer investimet objekt analize – blerjen e sipërfaqes së tokës 1000 m² në vitin 1998, në vlerën 2.000.000 lekë dhe ndërtimin e shtëpisë 2-katëshe, në vitin 1999, me kosto ndërtimi 3.756.187 lekë. Në zbatim të parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit, trupi gjykues i Kolegjit thekson që e gjen të konfirmuar diferencën negative që ka rezultuar nga analiza e kryer në Komision – në vlerën (-) 1.738.975 lekë [pasi në ndryshim nga Komisioni, në analizën financiare në Kolegj janë konsideruar të ardhurat nga pensioni i B. M. për vitin 2001].

28.3 Në konkluzion të gjithë sa më sipër arsyetuar, ndodhur në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme të kryefamiljarit, subjektit dhe anëtarëve të tjerë të familjes M., për blerjen e tokës dhe ndërtimin e banesës, pretenduar të kenë shërbyer më pas si burim krijimi i të ardhurave në shumën 30.000 euro, deklaruar nga subjekti si burim për shlyerjen e kredisë financuar nga Banka Emporiki ShA në vitin 2011 e, për pasojë, për krijimin e pasurisë apartament, ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dështoi të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur, sipas parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës.

28.4 Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk ka qenë konsekuent në konkluzionet e arritura. Ndërsa nga njëra anë Komisioni ka konkluduar për mungesë të burimeve financiare të ligjshme të familjes së subjektit dhe atij vetë për blerjen e tokës në vitin 1998 dhe ndërtimin e katit të parë të shtëpisë në vitin 1999 – 2001, nga ana tjetër, ky fakt rezulton të jetë abstraguar dhe Komisioni ka vlerësuar vetëm ligjshmërinë e përfitimit të shumës prej 30.000 eurosh, si pjesë e transaksionit në drejtim të detyrimeve tatimore, ka pranuar pretendimet e subjektit dhe këto fonde janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2011. Nën dritën e parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit në ankim, trupi gjykues në Kolegj ka konsideruar këtë shumë në analizën financiare të këtij viti.

28.6. *Për huan në shumën 7.000 euro, detyrim ndaj personave të tretë, të deklaruar si burim krijimi për apartamentin në rr. “{***}”, Tiranë – subjekti rezulton të ketë deklaruar detyrimin ndaj z. J. Zh. [si person fizik] në vlerën 7.000 euro dhe shlyerjet e kryera në deklaratat periodike vjetore për vitet 2006, 2007 dhe 2009, duke specifikuar vetëm vlerën 2.000 euro dhe faktin që në vitin 2009 detyrimi ishte shlyer. Nga ana tjetër, në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit, më datë 10.06.2019, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar mënyrën e shlyerjes së detyrimit ndaj z. J. Zh. si vijon: 2.000 euro në dhjetor 2007, 4.000 euro në dhjetor 2008 – deklaruar si “shuma të mbledhura gjatë vitit respektiv” dhe detyrimin e paguar më datë 28 dhjetor 2009, në vlerën prej 1.000 eurosh. Këtë të fundit, subjekti e deklaroi të marrë nga familjarët e tij, dhe të kthyer në fillim të shkurtit të vitit 2010 nëpërmjet shumës së akumuluar nga të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes, tërhequr nga banka. Subjekti ka deklaruar se pagesat ndaj z. J. Zh. janë kryer në *cash*.*

⁵⁸ *Vendimi i Këshillit të Ministrave përmban të dhëna për koston mesatare të ndërtimit për vitin 1998. Në këto kushte, Kolegji iu referua të dhënave zyrtare të Entit Kombëtar të Banesave për qytetin e Tiranës. Sipas këtij burimi, kostoja për sipërfaqe ndërtimi në vitin 1999 është 20.033 lekë/m². Për rrjedhojë, ndërtimi i banesës dykatëshe përlllogaritet në vlerën 2.504.125 lekë (125 m² x 20.033 lekë/m²) për katin e parë dhe 1.252.062 lekë (125 m² x 20.033 lekë/m²) për katin e dytë.*

28.7. Për sa më sipër pretenduar, në analizën financiare të kryer në Kolegj, shlyerja e detyrimit të subjektit të rivlerësimit J. Zh. është përlllogaritur siç është deklaruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se për këtë detyrim mungon dokumentacioni provues për shlyerjen e detyrimit [7.000 euro], ndërkohë që kështu dhe vlerat e detyrimit të shlyer nuk kanë gjetur pasqyrim në deklaratat e interesave privatë periodikë 2008 dhe 2009. Për pasojë, shlyerja e kësteve u përlllogarit sipas deklarimeve në hetimin administrativ, si vijon: në vlerën 2.000 euro në vitin 2007, në vlerën 4.000 euro në vitin 2008 dhe 1.000 euro në vitin 2009.

28.8. Rezultatet e analizës financiare të kryer në Kolegj konfirmuan konkluzionet e Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për vitin 2009, si arsyetuar në paragrafin 30 dhe nënpjesët e tij në këtë vendim, nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme financiare për të shlyer kështu e kredisë bankare, për të kursyer likuiditetet gjendje në llogaritë bankare, për të justifikuar shpenzimet për jetesë dhe të tjera të kryera në këtë vit, përfshirë këtu dhe shlyerjen e detyrimit 1.000 euro ndaj personit të tretë, në vlerën (-) 1.080.534 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

II. Analiza financiare për vitet 2009, 2011, 2013

29. Në përfundim të analizës financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, me të ardhurat e ligjshme, nuk ka pasur mundësi për të shlyer kështu e kredive bankare, për të përballuar shpenzimet jetike e shpenzime të tjera dhe për të kursyer likuiditete në llogaritë bankare. Nga analiza në vendimin e Komisionit, subjekti rezultoi me një bilanc negativ në vlerën (-) 1.105.131 lekë për vitin 2009, (-) 1.070.885 lekë për periudhën 1.01.2011 – 10.06.2011, dhe në vlerën (-) 463,857 lekë për vitin 2013. Në total, bilanci negativ, sipas Komisionit, është (-) 2.639.867 lekë. Analiza e shkaqeve të ankimit për secilën periudhë dhe konkluzioni i trupit gjykues shtjellohet në vijim.

30. *Për analizën financiare të vitit 2009* – Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti nuk ka pasur mundësi për të kryer shpenzimet dhe krijuar pasuritë [likuiditetet dhe krijuar gjendje në llogaritë bankare], duke rezultuar me një bilanc negativ prej (-) 1.105.131 lekësh. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon ka qenë pedagog i jashtëm i Universitetit {***}, për vitet shkollore në harkun kohor 2006-2013, fakt të cilin pretendon ta ketë deklaruar në deklaratat periodike për çdo vit të përfshirë në këtë periudhë kohore. Subjekti kërkon që t’i përfshihen në analizën financiare të vitit 2009, të ardhura në vlerën 664.200 lekë, të cilën pretendon ta ketë tërhequr *cash* në zyrën e financës së Universitetit {***}.

30.1. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin {***}, në vlerat 400.000 lekë + 210.000 lekë + 1.023.800 lekë. Një pjesë janë paguar në llogarinë e tij në Union Bank, ndërsa pjesa tjetër sipas vërtetimeve përkatëse nga Zyra e Financës së Universitetit. Për herë të parë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto të ardhura në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008 në shumën 310.000 lekë. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar të ardhura nga Universiteti {***}, në shumën 664.200 lekë, për periudhën 2006 – 2009, as në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as në deklaratën e interesave privatë 2009. Ky pretendim është ngritur për herë të parë gjatë procesit në Komision dhe në ankim. Subjekti pretendon që këtë shumë ta ketë tërhequr *cash* në zyrën e financës së Universitetit {***}, si detyrim i akumuluar që ky institucion kishte ndaj subjektit për periudhën 2006 – 2009, me një mandatpagesë, të cilën për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, nuk e disponon.

30.2. Sipas subjektit në ankim, për shkak të mungesës së dokumentacionit për periudhën 2007-2010, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 539, datë 06.08.2014⁵⁹, nuk e ka pasqyruar mësimdhënien në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin *vetting* për këtë periudhë. Në mbështetje të pretendimit për këto të ardhura, subjekti ka sjellë një shkresë⁶⁰ nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (në vijim “ASCAL”), sipas së cilës pretendon se provohet pagesa e përfituar prej tij nga mësimdhënia në Universitetin {***} për çdo vit akademik, nga viti 2006-2007 e në vijim. Sipas subjektit, përmbajtja e shkresës së ASCAL-it, për sa i përket pagesës prej 3.000 lekësh për leksion, pasqyrohet edhe në pagesën që i është bërë nga Universiteti {***} për vitin 2011, në vlerën 221.400 lekë që i korrespondon vlerës 3.000 lekë/orë mësimi për 75 leksione në vit, duke hequr edhe detyrimet tatimore që mban shkolla. Me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka depozituar, përveç shkresës së mësipërme, edhe dy shkresa nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë dhe Ministria e Arsimit, Kulturës dhe Sportit, pesë (5) deklaratat noteriale nga individë të ndryshëm⁶¹ dhe një akt vlerësimi kontabël.

30.3. Nga analizimi i këtyre akteve, trupi gjykues konstaton se, referuar akteve të përcjella nga arkiva e ASCAL-it, të cilat u referohen dy proceseve të akreditimit, respektivisht për vitet akademike 2007-2008 dhe 2012-2013, subjekti i rivlerësimit Ilir Mustafaj figuron si pjesë e stafit akademik, me 75 orë leksione në vit. Po ashtu, në akte gjendet plani i orëve mësimore për vitin akademik 2012-2013, ku evidentohet subjekti me numër rendor të caktuar në programin *bachelor*, dhe me një numër rendor tjetër në programin master i shkencave, lëndët përkatëse dhe statusi: *personel akademik me kontratë*. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky informacion nuk provon angazhimin faktik të subjektit të rivlerësimit në mësimdhënie, shumën e të ardhurave të përfituara nga ushtrimi i kësaj veprimtarie akademike, dhe as shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara. Në të njëjtën kohë, asnjë nga dokumentet e përcjella nga subjekti gjatë hetimit administrativ nuk përmban të dhëna zyrtare për këto të ardhura të pretenduara, përfshirë shkresën nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe atë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë⁶². Nga analizimi i përmbajtjes së shkresave të sipërcituara, nuk evidentohen të dhëna që të provojnë se subjekti i rivlerësimit pikërisht, ka qenë pedagog me kohë të pjesshme, i angazhuar në mësimdhënie, apo për pagesat e përfituara prej tij.

30.4. Referuar *aktit të vlerësimit kontabël* të datës 07 qershor 2019, eksperti kontabël B. P. përlllogarit të ardhurat nga mësimdhënia në Universitetin {***} për periudhën 2006-2007, 2007-2008, 2008-2009, bazuar në të dhënat e dokumentacionit të përcjellë nga ASCAL-i me shkresën nr. {***} prot., datë 11.01.2019, 3.000 lekë/orë mësimi. Eksperti kontabël mbështetet në pagesat e xhiruara në Union Bank ShA, në datën 11.07.2011, në shumën 221.400 lekë, e llogaritur 75 orë mësimi \times 3.000 lekë/ora = 225.000 lekë, dhe rezulton të ketë zbritur komisionet bankare prej 3.600 lekësh. Në analizë të këtyre të dhënave, trupi gjykues i Kolegjit, së pari konstaton që eksperti e konsideron *neto* pagesën për orë mësimdhënieje prej 3.000

⁵⁹ Ky vendim i hoqi licencën Universitetit {***} dhe 17 institucioneve të tjera të arsimit të lartë privat: http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/VKM_per_heqjen_e_licences.pdf.

⁶⁰ Shkresa nr. {***}, datë 11.01.2019, e ASCAL-it, përcjellë Komisionit nga subjekti së bashku me përgjigjet e pyetësorit të datës 30.01.2019.

⁶¹ Deklaratë noteriale e pedagogut dhe ish-dekanit të Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin {***}, z. A. Ll., si dhe deklaratat noteriale të studentëve, M. M., O. K., S. M., P. Gj., të cilët kanë ndjekur studimet për periudhën 2006-2012.

⁶² Shkresa nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve nuk përmban të dhëna për pagesat e kryera për pedagogët e jashtëm. Kjo shkresë konfirmon që të dhënat e regjistruara në bilance janë në total, jo analitike. Edhe shkresa e sjellë nga subjekti si përgjigje nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk përmban informacion në lidhje me dokumentacionin e personelit akademik të Universitetit {***}.

lekësh. Së dyti, dhe më e rëndësishme, të dhënat e përfshira në analizën e kryer në *Akt Vlerësimi Kontabël* nuk rezultojnë të provohen me dokumentacion justifikues ligjor/financiar.

30.5. Sa u përket deklaratave noteriale të depozituara nga subjekti me shpjegimet për rezultatet e hetimit [shih poshtëshënimin 61], si dhe ato bashkëlidhur ankimit depozituar në Kolegj [shih paragrafin 7.1 dhe poshtëshënimin 1 (i)] për të provuar mësimdhënien e subjektit të rivlerësimit si pedagog i jashtëm pranë Universitetit {***}, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se objekt shqyrtimi është shuma e të ardhurave të cilat subjekti i ka pretenduar për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit.

30.6. Më datë 09.04.2021, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegj edhe një kërkesë, nëpërmjet së cilës ka kërkuar që në shqyrtimin e ankimit të tij të trajtohet edhe një deklaratë noteriale [nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol.], datë 08.04.2021, nga z. S. S.⁶³. Subjekti sjell në vëmendje të Kolegjit faktin që gjatë procesit të rivlerësimit kryer për z. S., Komisioni i ka përllogaritur të ardhurat nga mësimdhënia për periudhën 2006-2011 në disa universitete.

30.7. Trupi gjykues i Kolegjit vëren që vendimi i Komisionit [me nr. {***}, datë 17.01.2020], që ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit S. S., rezulton të ketë specifikuar në arsyetim që të ardhurat nga pagat dhe honorarët nga mësimdhënia janë përllogaritur mbi bazën e vërtetimeve për të ardhurat nga pagat dhe honorarët në vlerë neto, lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten, që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës [shih faqen 15, pika 5, paragrafi i parë dhe faqen 39, paragrafi i dytë i vendimit nr. {***}, datë 17.01.2020 të Komisionit]. Të njëjtën praktikë Komisioni e ka mbajtur dhe për subjektin e rivlerësimit Ilir Mustafaj, duke pasur në konsideratë të ardhurat e deklaruar në deklaratat periodike dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, të cilat provohen me dokumentacion ligjor duke përmbytur kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Nga ana tjetër, deklarata noteriale e z. S., duke qenë me karakter tejet deklarativ dhe e pambështetur në dokumentacion ligjor apo financiar që do të provonte të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për të cilat janë paguar detyrimet tatimore nga mësimdhënia në fjalë, nuk ka vlerë provuese për çështjen në shqyrtim.

30.8. Për sa më sipër dhe duke abstraguuar nga vlera e kufizuar provuese e deklaratave noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit sipas jurisprudencës së Kolegjit, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje që, në bazë të përcaktimeve të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të dhënat e deklaruar do merrnin fuqi provuese nëse harmonizohen me prova të tjera, dhe të ardhurat e pretenduara të përfituara nga ky universitet për periudhën 2006-2009, të ishin deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësim, *vetting*, dhe/ose në deklaratat e interesave private periodike vjetore apo do të kishte një gjurmë dokumentare nëpërmjet pagesave në llogarinë bankare.

30.9. Përpos sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se nga konfermat bankare të përcjella nga Union Bank ShA⁶⁴, të ardhurat nga mësimdhënia në Universitetin {***}, datojnë nga viti 2010 deri në vitin 2013, në shumën 1.023.800 lekë (konkretisht: 74.400 lekë/viti 2010, 221.400 lekë/viti 2011, 378.000 lekë/viti 2012 dhe 350.000 lekë/viti 2013). Nuk rezulton që subjekti të

⁶³ Nëpërmjet deklaratës noteriale, z. S. S. deklaron, ndër të tjera, që subjekti i rivlerësimit ka qenë pedagog i jashtëm në Universitetin {***} në të njëjtat fasha orare dhe në të njëjtat ditë me atë vetë, për gjithë vitet akademike në periudhën kohore 2006-2013. Deklaruesi specifikon edhe pagesën për orë mësimi që ka përfutuar ai vetë.

⁶⁴ Shkresa nr. {***} prot., datë 05.02.2019, e Union Bank ShA drejtuar Komisionit për kreditimet vjetore në llogarinë e klientit Ilir Mustafaj nga institucionet arsimore "{***}" ShPK, "{***}" ShPK dhe "{***}" ShPK.

ketë përfituar nëpërmjet bankës pagesë për mësimdhënie nga Universiteti {***} gjatë periudhës 2006-2009.

30.10. Në përmbledhje, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat nga mësimdhënia në ish-Universitetin {***} në vitin 2009, në shumën 664.200 lekë, të cilat nuk janë deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësim, *vetting*, dhe as në deklaratën e interesave privatë 2009, trupi gjykues vlerëson se nuk u provua me dokumentacion ligjor ekzistenca dhe ligjshmëria e këtyre burimeve, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, *pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore*. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit, ashtu si edhe Komisioni, nuk i përfshiu në analizën financiare të kryer në Kolegj këto të ardhura. Pretendimi i subjektit në ankim nuk është i bazuar.

30.11. Trupi gjykues i Kolegjit vëren edhe që pretendimi i subjektit të rivlerësimit që Komisioni duhet të kishte ndërmarrë hetime të tij për të gjetur dokumentacionin dhe për pamundësinë objektive të subjektit në këtë drejtim, është po ashtu i pabazuar. Së pari, siç arsyetohet edhe më sipër në detaj, barra e provës për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave i përket vetë subjektit të rivlerësimit. Së dyti, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin edhe ndër vite, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, që të provonte me dokumentacion ligjor të gjitha të ardhurat, të cilat mund të ishin objekt i kontrollit të deklaratës së pasurive dhe interesave privatë nga ILDKPKI-ja. Së fundmi, në kuadër të procesit të rivlerësimit, detyrimi për të deklaruar dhe mbështetur me dokumentacion ligjor të ardhurat, ishte pjesë e dispozitave kushtetuese dhe ligjore e nënligjore. Për këto arsye, pretendimi për të përlllogaritur të ardhura të cilat për herë të parë deklarohen gjatë hetimit, për të cilat subjekti pretendon pamundësi objektive për dokumentacion, vite pasi ka pasur minimalisht një detyrim periodik për t’i deklaruar dhe provuar ato të ardhura, mbetet i pabazuar në fakte dhe në ligj.

30.12. Lidhur me huan e marrë në vitin 2009 nga z. F. Xh., trupi gjykues konstaton se Komisioni, në analizën financiare të kryer për vitin 2009 [paragrafi 83 i vendimit objekt shqyrtimi], ka përfshirë në përlllogaritje vlerën (-)137.960 lekë, me përshkrimin “detyrim ndaj personave fizikë J. Zh.”, shenja negative përpara vlerës tregon që ky detyrim është shlyer, ndërkohë që nuk përfshin shumën 1.000 euro, të pretenduar nga subjekti të marrë hua nga baxhanaku F. Xh. Subjekti i rivlerësimit për shumën më sipër, ka ngritur pretendimin se Komisioni e ka përlllogaritur atë si shpenzim, por jo si të ardhur. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar marrjen e një huaje në vlerën 1000 euro në vitin 2009 nga një familjar i tij [z. F. Xh.] për të shlyer huan ndaj z. J. Zh. [shih paragrafin 28.7 më sipër], por nuk e ka deklaruar këtë detyrim financiar as në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2009, si burim për shlyerjen e detyrimit ndaj z. Zh. Vlen për t’u theksuar që në këtë të fundit [DIPPV 2009], subjekti ka shënuar edhe:

[...] nuk ekziston më detyrimi ndaj J. Zh.. Detyrimi ndaj tij është likuiduar për vitet 2008, 2009. Në deklarimin e vitit 2008 kam harruar detyrimin që kam shlyer ndaj z. Zh. (i papasqyruar në deklarim) [...].

30.13. Për herë të parë, ky pretendim është ngritur nga subjekti i rivlerësimit me shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ, ku subjekti ka pretenduar se huan e ka shlyer brenda 40 ditësh dhe nuk e ka deklaruar për shkak të neglizhencës. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision *deklaratë noteriale të z. F. Xh., datë 06.06.2019 [me nr. {***} rep./kol.]*, i cili ka konfirmuar sa pretendon subjekti, e konkretisht që në dhjetor të vitit 2009 i ka dhënë subjektit të rivlerësimit shumën prej 1.000

(një mijë) eurosh, për nevojat e tij, për shlyerjen e një detyrimi banese që kishte marrë, dhe ky detyrim është likuiduar në shkurt të vitit 2010.

30.14. Trupi gjykues i Kolegjit nuk e përllogariti në analizën financiare të kryer në Kolegj për vitin përkatës shumë e pretenduar të financuar nga z. Xh., në kushtet kur ajo nuk provohet me dokumentacion justifikues ligjor të kohës, nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën për rivlerësimin e pasurisë *vetting* apo deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2009, 2010, në përmbushje të detyrimit ligjor si subjekt deklarimi, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003. Për më tepër, në aktvlerësimin kontabël, datë 07.06.2019 [hartuar një ditë pas deklaratës noteriale], depozituar nga subjekti me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, eksperti nuk ka përfshirë në të hyra, shumë 1.000 euro, pretenduar të marrë hua nga z. F. Xh. Ndërsa në shtesë aktvlerësimi kontabël, datë 04.11.2019, eksperti e ka përfshirë këtë hua në analizën financiare të vitit 2009. Vlen të theksohet se në dy aktet e vlerësimit kontabël, rezultati financiar për vitin 2009, si përllogaritur nga eksperti kontabël i subjektit, tregon diferencë negative [(-) 142.978 lekë dhe (-) 5.018 lekë], pra pamjaftueshmëri burimesh financiare të ligjshme për këtë vit.

30.15. Në përfundim, nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2009, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme financiare për të shlyer këstet e kredisë bankare, për të kursyer likuiditetet gjendje në llogaritë bankare, për të justifikuar shpenzimet për jetesë dhe të tjera të kryera në këtë vit, në vlerën – 1.080.534 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

31. *Për analizën financiare të periudhës 01.01.2011 deri 10.06.2011* – Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti nuk ka pasur mundësi për të shlyer këstet e kredive bankare për të përballuar shpenzimet jetike dhe për të kursyer likuiditete [cash ose në llogaritë bankare], si dhe për shpenzime të tjera, duke rezultuar me një bilanc negativ në vlerën (-) 1.070.885 lekë. Subjekti në ankim pretendon që Komisioni duhet të kishte përfshirë të ardhurat në vlerën 400.000 lekë, të përfituara prej tij nga udhëheqjet e diplomave në Universitetin {***}, tërhequr në fund të majit 2011, në zyrën e financës së këtij universiteti. Në mbështetje të këtij kërkimi, subjekti referon vërtetimin e datës 25.07.2011, fakt ky i pranuar edhe nga Komisioni në vendimin e arsyetuar. Vlera e përfituar në vitin 2011 nga mbrojtja e diplomave në Universitetin {***}, sipas subjektit është shumë e cila njihet nga Komisioni në vendim, por jo në periudhën reale në të cilën ajo është përfituar.

31.1. Nga shqyrtimi i analizës financiare të kryer në Komision për vitin 2011 [Analiza financiare 10.06.2011], trupi gjykues konstaton që në paragrafin 105, faqe 25⁶⁵ e vendimit objekt shqyrtimi, është përfshirë në të ardhurat e përfituara nga subjekti edhe shuma prej 400.000 lekësh dhe referuar shprehimisht prejardhja. Për këtë arsye, trupi gjykues e gjen të pakuptimtë këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit për mospërfshirjen në periudhën reale të kësaj shume.

31.2. Subjekti pretendon në ankim se Komisioni duhet të kishte përllogaritur ndër të ardhurat e tij, edhe shumë prej 600.000 lekësh, kontribuar nga individë të ndryshëm me rastin e ceremonisë mortore të nënës, 21.03.2011. Sipas subjektit, vlera 600.000 lekë, e grumbulluar në këtë mënyrë, ishte gjendje në datën 10.06.2011 (kur është paguar shuma 10.300 euro), por në përfundim të vitit nuk ka shërbyer për shtimin e pasurisë së subjektit, për shkak se ashtu siç është përfituar, edhe është shpenzuar brenda një periudhe të shkurtër kohore brenda vitit.

⁶⁵ Faqe 25 e vendimit të Komisionit nr. 180, datë 18.07.2019, tabela “Analiza financiare përfundimtare për subjektin për vitin 2011”, periudha 01.01 - 10.06.2011, kolona e djathtë, rreshti IV i rubrikës së të ardhurave, ku në mënyrë specifike referohet “udhëheqje diplomash {***}”.

31.3. Nga shqyrtimi i akteve në fashikull, rezulton që kjo shumë e pretenduar nga subjekti në vitin 2011, është deklaruar për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit, me rezultatet e hetimit administrativ. Me fjalë të tjera, kjo shumë e përfituar nga subjekti nuk është pasqyruar as në deklaratën e pasurisë për rivlerësim, *vetting*, dhe as në deklaratën e interesave privatë periodikë 2011, apo në deklaratat e viteve në vijim si shtesë, pakësim apo e përdorur gjatë vitit për ndonjë shpenzim “sipas së drejtës zakonore”, siç pretendon subjekti në përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ. Nuk rezulton po ashtu që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar shumën e mësipërme si e ardhur apo si burim krijimi të ndonjë pasurie, konkretisht të shumës 10.000 euro, depozituar nga subjekti më datë 10.06.2011, në llogarinë e tij në Emporiki Bank ShA, si pretendon gjatë hetimit administrativ⁶⁶. Për këto arsye, trupi gjykues e gjen këtë pretendim të subjektit deklarativ dhe jobindës. Në kushtet kur e ardhura në shumën 600.000 lekë në vitin 2011, rezulton e padeklaruar më parë dhe e paprovuar me dokumentacion justifikues ligjor, kjo shumë nuk u përlllogarit as në analizën financiare të kryer në Kolegj, sikurse edhe në Komision.

31.4. Subjekti në ankim kundërshton mospërfshirjen e vlerës prej 130.000 lekësh në analizën financiare për periudhën 01.01 - 10.06.2011 nga ana e Komisioni. Sipas tij, këto të ardhura janë përfituar në formë *cash*-i nga pjesëmarrja në grupin e punës në një konferencë ndërkombëtare⁶⁷ dhe janë deklaruar në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2011. Sipas subjektit, nuk e ka deklaruar këtë shumë në deklaratën *vetting* për shkak të mosgjatjes së dokumentacionit përkatës, për shkak të kohës që ka kaluar. Në përfundim, subjekti kërkon që në analizë, Kolegji t'i referohet shtesë aktvlerësimit kontabël – shtjelluar edhe më sipër.

31.5. Nga mënyra se si është shprehur në deklarinimin e vitit 2011 subjekti, duket se e ardhura e pretenduar është rezultat i pjesëmarrjes së subjektit të rivlerësimit në disa konferenca, brenda dhe jashtë vendit, pasi thuhet: “[...] të ardhura nga pjesëmarrja në Konferenca Ndërkombëtare dhe Kombëtare në fushën e së drejtës [...]”. Me fjalë të tjera, vetë subjekti është kontradiktor pasi, ndërsa në ankim pretendon se shuma prej 130.000 lekësh vjen e gjitha nga një konferencë në Romë, në deklaratën periodike të vitit 2011 flet për konferenca në numrin shumës dhe në vendndodhje të ndryshme jashtë e brenda Shqipërisë. Përpos kësaj kontradikte, trupi gjykues sjell në vëmendje që subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë provuar të ardhurat e pretenduara me asnjë lloj dokumentacioni. Më tej, trupi gjykues vëren që edhe eksperti kontabël i subjektit të rivlerësimit, në aktin e ekspertimit fillestar të datës 7 qershor 2019, nuk rezulton ta ketë përlllogaritur këtë shumë të ardhurash, ndërsa e përlllogarit në shtesën e aktvlerësimit kontabël, të hartuar në datën 4 nëntor 2019, nën zërin “të hyra”. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit në shumën 130.000 lekë, mbetën në nivel deklarativ e, për pasojë, nuk përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës për t'u përfshirë në analizën financiare të kryer në Kolegj, sikurse edhe në Komision.

31.6. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë periodikë 2011, sikurse edhe në deklaratën e pasurisë për rivlerësim [*vetting*] depozitën në *cash* të shumës prej 10.000 eurosh, më datë 10.06.2011, në llogarinë e tij të depozitës në euro pranë Emporiki Bank ShA, si dhe burimin e krijimit të saj. Për të shpjeguar burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka paraqitur Akt Vlerësimin Kontabël në Komision dhe në ankim, Shtesë Akt Vlerësimi Kontabël, të hartuar nga i njëjti ekspert më 04.11.2019. Sipas të dyja akteve, situata financiare e subjektit të rivlerësimit sipas përlllogaritjes së ekspertit del pozitive. Konkretisht, subjekti rezulton me tepriçë në shumën 1.409.162 lekë në datën 10 qershor 2011. Këtë shumë, subjekti pretendon ta ketë përdorur si burim për krijimin e shumës 10.300 euro. Nga analizimi i *lëvizjeve të llogarive*

⁶⁶ Faqe 22, paragrafi i katërt i shpjegimeve të subjektit mbi rezultatet e hetimit administrativ, datë 10.06.2019.

⁶⁷ Organizuar nga Universiteti “{***}”, Romë, në maj të vitit 2011.

bankare të subjektit të rivlerësimit në monedhën euro në Emporiki Bank ShA, rezulton që këtë shumë [10.300 euro] së bashku me shumën 25.000 euro [nga 30.000 euro] të paguara nga shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK [“{***}”] subjekti i rivlerësimit e ka përdorur më datë 05.07.2011 për likuidimin tërësor në shumën 34.602 euro, të kredisë së financuar nga Emporiki Bank ShA, që ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit të ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë.

31.7. Trupi gjykues konstaton se subjekti, nëpërmjet ekspertit, bën përllogaritje të gabuara të të ardhurave, pasi nuk përfshin në to të ardhurat nga pagat, por totalin e shumave të tërhequra nga llogaritë bankare për periudhën 01.01 - 10.06.2011. Në terma financiarë, tërheqjet nga llogaritë bankare konsistojnë në likuiditete të ruajtura në këto llogari. Nga ana tjetër, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 dhe nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, shumat e tërhequra do të konsideroheshin në analizën financiare si kursime të përdorura për krijimin e depozitës nëse do të ishin deklaruar nga subjekti si burim krijimi në deklaratat e interesave privatë periodikë. Sipas parimeve të kontabilitetit, veprimi financiar nuk mund të pasqyrohet dy herë gjatë hartimit të analizës, pasi këto tërheqje pasqyrohen në çdo rast në zërin “ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve” (shtesë/pakësim). Gjithashtu, me konsideratë vlerësimin ligjor të kryer në paragrafët 31.2 - 31.5 në këtë arsyetim, e ardhura në shumën 600.000 lekë dhe ajo në shumën 130.000 lekë nuk përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson që edhe depozita në shumën 10.300 euro nuk është krijuar me të ardhura nga burime të ligjshme.

31.8. Trupi gjykues i Kolegjit kreu edhe analizën financiare për të vlerësuar mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur për të justifikuar me të ardhura të ligjshme krijimin e kursimit në shumën 10.300 euro, depozituar në llogarinë e tij bankare në Emporiki Bank ShA, më datë 10.06.2011. Në konkluzion, nga kjo analizë, për periudhën 01.01.2011 – 10.06.2011, rezultoi që subjekti i rivlerësimit ka pasur pamjaftueshmëri të burimeve financiare. Nga analiza e kryer në Kolegj, subjekti i rivlerësimit rezulton me një diferencë negative më të thelluar sesa ajo e kryer në Komision për të krijuar kursime në shumën 10.300 euro, për të shlyer detyrimet për kredinë e financuar nga Emporiki Bank ShA, për të justifikuar shpenzimet e jetesës dhe të tjera kryer këtë periudhë, e konkretisht në vlerën (-) 1.223.630 lekë. Nën dritën e parimit të mospërkeqësismit të pozitës së subjektit në ankim, trupi gjykues konkludon që balanca negative e përllogaritur nga Komisioni për këtë periudhë kohore, në vlerën (-) 1.070.885 lekë, konfirmohet dhe subjekti gjendet me mungesë të burimeve të ligjshme, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

32. *Për analizën financiare të vitit 2013*, Komisioni ka arritur në përfundimin se me të ardhurat e ligjshme, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për të shlyer këstet e kredive bankare, për të përballuar shpenzimet jetike, për të kursyer likuiditete në llogaritë bankare, si dhe për shpenzimet e tjera. Për rrjedhojë, Komisioni ka konstatuar se subjekti rezulton me një bilanc negativ prej (-) 463.857 lekësh. Subjekti ka kundërshtuar rezultatet e analizës financiare të kryer për vitin 2013 nga Komisioni, duke sjellë në vëmendje: (i) Përllogaritje më tepër të një vlere prej 600 eurosh për shkollimin e djalit në vitin 2013, sipas vërtetimit të lëshuar nga shkolla “{***}”, i datës 04.02.2019, i paraqitur si provë në seancën publike të datës 11.07.2019; (ii) vlerën prej 210.000 lekësh, të përfituar nga mbrojtja e diplomave në Universitetin {***}, në vitin 2012, pasqyruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2012, si dhe në dokumentacionin shoqëruar të deklaratës, tërhequr *cash* në zyrën e financës së universitetit në fund të vitit 2012 dhe përdorur gjatë vitit 2013 (si sqaruar në aktekspertimin shtesë, datë 04.11.2019); dhe së fundmi, (iii) për vitin 2013 duhen përllogaritur shpenzime jetese më të ulëta sesa vlera e përllogaritur nga Komisioni. Të ardhurat që familja ka pasur në dispozicion kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e bëra gjatë këtij viti.

32.1. Trupi gjykues arsyeton për çdo pretendim më sipër, si vijon:

(i) Ndryshe nga Komisioni, në analizën financiare të kryer në Kolegj për vitin 2013, shpenzimet për shkollimin e djalit të subjektit të rivlerësimit për vitin akademik 2013-2014, janë konsideruar në vlerën 300 euro sipas vërtetimit të lëshuar nga shkolla⁶⁸ për pagesën në vlerën 300 euro.

(ii) Lidhur me vlerën 210.000 lekë, përfituar nga mbrojtja e diplomave në Universitetin {***} në vitin 2012, nga dokumentacioni⁶⁹ i përcjellë Komisionit nga Union Bank ShA, rezulton se subjekti i rivlerësimit është kredituar nga viti 2010-2013 nga Universiteti {***}, në vitin 2012 në vlerën 378.000 lekë. Së dyti, nga dokumentacioni në dosjen gjyqësore, nuk rezultoi që subjekti të ketë depozituar dokumentacion justifikues ligjor për shumën e pretenduar më sipër. Së treti, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimi që shuma është tërhequr *cash* në fund të vitit 2012 dhe është përdorur gjatë vitit 2013, është ngritur për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit. Këtë shumë subjekti e ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë periodikë 2012 si “të ardhur”, por nuk rezulton ta ketë deklaruar kursime në *cash* në banesë në deklaratën e interesave privatë periodikë 2012, sikurse subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar se ka përdorur kursime *cash* mbartur nga viti 2012 në deklaratën e interesave privatë të vitit 2013. Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerësoi të mos konsiderohet në “të ardhura/të hyra”, në analizën financiare të kryer për vitin 2013. Sipas vlerësimit ligjor të kryer në Kolegj, në analizën financiare janë konsideruar vetëm të ardhurat që i janë paguar subjektit nëpërmjet llogarive bankare, të provuara me dokumentacion ligjor, të cilat përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

(iii) Lidhur me pretendimin për shpenzimet jetike më të ulëta sesa ato që janë përlllogaritur në analizën financiare të kryer në Komision për vitin 2013, trupi gjykues vëren së pari, që subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion i cili vërteton se si shpenzimet jetike janë nën vlerën e pretenduar. Përkundrazi, vetë subjekti i rivlerësimit, me aktvlerësimin kontabël të datës 07 qershor 2019, paraqitur në cilësinë e provës për rezultatet e analizës financiare të Komisionit, dhe në shtesë aktvlerësimin kontabël të datës 04.11.2019, paraqitur me ankimin, e ka përlllogaritur vlerën e shpenzimeve jetike/konsum në vitin 2013, në vlerën 881.520 lekë për familje me katër anëtarë. Për këto arsye, ky pretendim i subjektit në ankim gjendet i pabazuar. Vlen të theksohet se në dy aktet, rezultati financiar për vitin 2013, si përlllogaritur nga eksperti kontabël i subjektit, tregon diferencë negative [(-) 287.353 lekë dhe (-) 203.227 lekë], pra pamjaftueshmëri burimesh financiare të ligjshme për këtë vit.

32.2. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2013, subjekti rezulton me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 391.448 lekë, për të justifikuar me të ardhura nga burime të ligjshme kursimet e krijuara gjendje në llogari bankare, shpenzimet e tjera të kryera në këtë vit, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

33. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pasi analizoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit në lidhje me ankimin dhe pasi shqyrtoi provat e administruara në këtë çështje, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dështoi të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur, si dhe rezultoi të ketë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të shlyer këstet e kredive bankare, për të përballuar shpenzimet jetike e shpenzime të tjera, dhe për të kursyer likuiditete në llogaritë bankare për vitin 2009, për periudhën 01.01.2011 – 10.06.2011, dhe vitin 2013, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Në Kolegj, totali i diferencave negative, rezultuar nga analizimi i pasurive të subjektit dhe personit të lidhur, ka rezultuar në vlerën 2.695.612 lekë. Trupi gjykues në përfundim, në zbatim të parimit të mospërkeqësimit të

⁶⁸Shkolla 12-vjeçare jo publike "{***}", vërtetim i datës 04.02.2019, nënshkruar nga administratorja e shoqërisë "{***}" ShPK.

⁶⁹Shkresë nr. {***} prot., datë 05.02.2019.

pozitës së subjektit, konfirmon mungesën e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, që ka rezultuar në Komision.

34. Në këto kushte, trupi gjykues në Kolegj, mbështetur në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, dhe çmon se vendimi nr. 180, datë 18.07.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 180, datë 18.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ilir Mustafaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 22.07.2021.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores, kam mbajtur qëndrim kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për çështjen (JR) nr. 58, datë 12.11.2019, me ankim të subjektit të rivlerësimit Ilir Mustafaj, kundër vendimit nr. 180, datë 18.07.2019, të Komisionit Pavarur të Kualifikimit.
2. Qëndrimin tim kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues, e mbështes në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, në ligj, prova dhe fakte të administruara në Komision dhe në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

I

3. Në cilësinë e gjyqtares në pakicë, kundërshtoj vendimin e marrë nga shumica e trupit gjykues për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit nr. 180, datë 18.07.2019, pasi çmoj se në shqyrtimin e çështjes në Komision, ashtu dhe në Kolegj, nuk janë vlerësuar drejt rrethanat e fakteve në përputhje me provat e administruara në dosje, rrjedhojë e konstatimit të gjendjes faktike në mënyrë jo të plotë dhe të pasaktë, me pasojë zgjidhjen jo të drejtë të çështjes, Për sa sipër, arsyetoj:

i. Për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike

4. Lidhur me shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, në cilësinë e relatores së çështjes, në zbatim të parashikimeve të nenit 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me fillimin e seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 22.07.2021, kam propozuar marrjen paraprake në shqyrtim të deklaratave noteriale, depozituar nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, listuar në vijim:
 - i. Deklaratë noteriale nr. {***} rep. nr. {***} kol., datë 04.11.2019 e z. G. M.;
 - ii. Deklaratë noteriale nr. {***} rep. nr. {***} kol., datë 04.11.2019 e znj. E. B.;
 - iii. Deklaratë noteriale nr. {***} rep. nr. {***} kol., datë 04.11.2019 e z. E. P., anëtar i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë;
 - iv. Deklaratë noteriale nr. {***} rep. nr. {***} kol., datë 24.10.2019 e z. L. M.;
 - v. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.04.2021, e z. S. S., anëtar i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.
5. Në zbatim të kërkesave të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke çmuar se këto deklarata i shërbenin qartësisht të situatës faktike dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, kam kërkuar shqyrtimin dhe analizimin e tyre në seancë gjyqësore publike, pasi kam vlerësuar se këto akte përbëjnë dokumente nga burime të njohura, prova të besueshme, në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera në dosje dhe do t'i shërbenin trupës gjykuese të Kolegjit në vendimmarrjen e duhur.
6. Nën vlerësimin tim, konstatimi i gabuar dhe në mënyrë jo të plotë i gjendjes faktike nga ana e Komisionit mbi dokumentacionin e administruar, në zbatim të nenit 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, që parashikon:

1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se:

a) [...];

b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë;

– me konsideratë dhe aktet e depozituara nga subjekti në Kolegj, kam kërkuar nga trupi gjykues marrjen e tyre në cilësinë e provës dhe shqyrtimin e tyre në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit, por shumica e trupit gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, mbi bazë aktesh, duke arsyetuar se këto akte shkresore të sjella nga subjekti i rivlerësimit, së bashku me ankimin, nuk përmbushin kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

7. Arsyet që më çuan në propozimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore publike, marrin shkas nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore, të cilat Komisioni, në vlerësimin tim, ka dështuar t’i analizojë drejt dhe t’u japë vlerën provuese. Harmonizimi i informacionit të këtyre akteve me deklaratat në deklaratat noteriale të sipërcituara, më krijuan bindjen që subjekti i rivlerësimit është i sinqertë në kërkimet e tij lidhur me të ardhurat nga mësimdhënia në Universitetin {***}, të cilat për pasojë ndikojnë në gjendjen financiare të vitit 2009, për subjektin e rivlerësimit.
8. Nga shqyrtimi analitik i akteve në dosjen gjyqësore, konstatoj se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit një sërë provash me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, në kuadër të barrës së provës, parashikuar në nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016, duke i vlerësuar të mjaftueshme për të provuar të kundërtën e këtyre rezultateve. Në kushtet kur Komisioni në vendim, nuk ka marrë në konsideratë vlerën provuese të akteve të depozituara, subjekti i rivlerësimit, për të provuar të ardhurat nga Universiteti {***} për vitin 2009, ka ndërmarrë iniciativën të paraqesë në Kolegj deklaratat noteriale të ish-pedagogëve, kolegë të tij, gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, përfshirë dhe gjyqtar, ish-subjekt rivlerësimi, që ka kaluar me sukses këtë proces, të cilët deklarojnë nën përgjegjësinë ligjore, që subjekti i rivlerësimit Ilir Mustafaj ka qenë i angazhuar në mësimdhënie për periudhën 2006-2009, dhe pagesa nga ky universitet *bëhej me shumë vonesë, nëpërmjet zyrës së financës.*
9. Për shkak të bindjes sime, të përforcuar nga fakti që deklaratat noteriale, *së pari* nuk janë lëshuar nga individë të cilët plotësojnë kërkesat e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pra deklaruesit nuk janë në kushtet e dhuruesit, huadhënësit apo huamarrësit dhe nuk i lidh asnjë interes pasuror apo familjar me subjektin e rivlerësimit, *së dyti*, deklaratat noteriale janë lëshuar nga kolegë, pedagogë, pjesë e të njëjtit staf akademik të Universitetit {***}, të cilët ushtrojnë aktualisht pozicionin e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë dhe, për shkak të reputacionit dhe përgjegjësisë në ushtrimin e funksionit të tyre, nuk mund të lëshonin deklarata noteriale nëse informacioni nuk do të ishte i saktë, kam vlerësuar që trupi gjykues duhej të merrte në cilësinë e provës këto deklarata noteriale të depozituara në Kolegj, pastaj për vlerën provuese të tyre të vendosnin sipas bindjes së tyre të brendshme.
10. Duke mos iu shmangur në asnjë moment gjatë vlerësimit tim jurisprudencës së konsoliduar tashmë të Kolegjit, në qëndrimin e mbajtur mbi deklaratat noteriale të bëra gjatë procesit të rivlerësimit, në rastin objekt shqyrtimi, mendoj se këto deklarata nuk kanë vetëm efekt deklarativ, por harmonizohen me akte të tjera të administruara në dosjen gjyqësore, të cilat do të analizohen në detaj më poshtë në këtë mendim pakice, që nën vlerësimin tim paraqesin fakte e rrethana bindëse për të provuar pretendimin e subjektit. Për këtë arsye, çmoj se për të garantuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit në këtë proces, në kuadër të zgjidhjes sa më të drejtë dhe sa më të plotë të çështjes, këto deklarata duhet të ishin pranuar në cilësinë provës nga trupi gjykues i Kolegjit.
11. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues që vlerësoi se kërkesa e subjektit të rivlerësimit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe riçeljen e hetimit administrativ nuk përmbush sa parashikuar në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, në cilësinë e relatores, nga

vlerësimi tërësor i akteve në dosje, çmoj se ndodhemi në kushtet e këtij neni, konkretisht pika 1, germa “b”, pjesa e dytë e fjalisë, ku për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike nga ana e Komisionit, debati gjyqësor ishte i nevojshëm për t’i dhënë mundësi subjektit të mbrojtë të drejtat/interesat e tij, në kuadër të një hetimi të plotë, të gjithanshëm dhe ezaurues, duke mos cenuar as në dukje të drejtën e subjektit për një proces të rregullt ligjor. Po kështu, kam vlerësuar se nëse deklaratat noteriale do t’i ishin nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, do të rezultonin bindëse e, për rrjedhojë, do të sillnin ndryshimin e rezultateve të analizës financiare të kryer në Komision në favor të subjektit.

ii. Për analizën financiare

12. *Për analizën financiare të vitit 2009, Komisioni në vendim, ka arritur në përfundimin se: për vitin 2009 me të ardhurat e ligjshme – subjekti nuk ka pasur mundësi për të shlyer këstet e kredive bankare, për të përballuar shpenzimet jetike dhe për të kursyer likuiditetet dhe krijuar gjendje në llogaritë bankare, dhe për shpenzime të tjera, duke rezultuar me një bilanc negativ prej – 1.105.131 lekë.*

Shumica e trupit gjykues në Kolegj, ka vlerësuar se *subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme financiare për të shlyer këstet e kredisë bankare, për të kursyer likuiditetet gjendje në llogaritë bankare, për të justifikuar shpenzimet për jetesë dhe të tjera të kryera në këtë vit, në vlerën – 1.080.534 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*

13. Komisioni, në paragrafët 81.3 dhe 82 të vendimit të tij, shprehet:

*81.3 Prova e depozituar nga subjekti i rivlerësimit, me shkresën nr. {***}, datë 11.1.2019, të Agjencisë të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, provon vetëm se subjekti ka qenë parashikuar si pjesë e stafit akademik të universitetit në momentin e aplikimit për dhënie license këtij të fundit pranë Ministrisë së Arsimit, por nuk provon mësimdhënien faktike në vitet 2006 – 2009, pranë këtij universiteti. Trupi gjykues i Komisionit, ka vlerësuar se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nuk përbën provë për të vërtetuar periudhën e plotë të punësimit të pretenduar apo masën e të ardhurave të përfituara nga ky punësim, dhe pagimin e tatimit mbi këto të ardhura.*

*82. Komisioni arrin në përfundimin se të ardhurat e përfituara pretenduara prej tij (marrë cash) nga Universiteti {***} në vitin 2009, nuk duhen përfshirë në analizën financiare për këtë vit.*

14. Nëpërmjet deklaratave të mësipërme të paraqitura në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të provojë të ardhurat për vitet akademike 2006-2007, 2007-2008, 2008-2009 (tri vite) si pedagog me kohë të pjesshme pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti {***}, Departamenti i së Drejtës Civile, për lëndën “E drejta e detyrimeve dhe kontratave”, ku mësimi zhvillohej në fundjavë, në ditët e shtunë dhe e diel, të ardhura të cilat ndikojnë në analizën e gjendjes financiare të tij.
15. Në mbështetje të pretendimit për të ardhurat nga mësimdhënien në Universitetin {***} për vitet 2006 – 2009, subjekti ka depozituar në Komision shkresën nr. {***}, datë 11.01.2019, të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), se referuar *dokumente të Shkollës së Lartë Universitare Jo Publike Universiteti {***}*, përcjellë Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë me shkresën nr. {***} prot., datë 27.05.2008, në kuadër të dy proceseve të akreditimit, respektivisht për vitet akademike 2007-2008 dhe 2012-2013, sikurse gjenden në arkivën e ASCAL, me numrin rendor 49 evidentohet subjekti i rivlerësimit Ilir Mustafaj si pjesë e stafit akademik, me 75 orë leksione në vit, për lëndën “E drejta e detyrimeve”. Bashkëlidhur gjendet plani i orëve mësimore për vitin akademik 2012-2013, ku evidentohet subjekti me numër rendor 19, për lëndën e sipërcituar në programin *bachelor*, dhe

me numër rendor 11, në programin master i shkencave, lënda “Përgjegjësia jashtëkontraktore”, me status *personel akademik me kontratë*.

16. Nga shqyrtimi i rrethanave e provave mbi të ardhurat nga Universiteti {***}, për periudhën 2006 – 2009, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka ezauruar të gjitha mjetet e mundshme në sigurimin e dokumentacionit justifikues ligjor për të provuar të kundërtën e barrës së provës, lidhur me këto të ardhura, në shumën 664.200 lekë, në vitin 2009, duke depozituar në cilësinë e provës gjatë hetimit administrativ në Komision, një sërë dokumentesh të lëshuara nga institucionet shtetërore: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Drejtoria e Tatimeve, si dhe një sërë deklaratash noteriale nga ish-pedagog dhe studentë, që provojnë pretendimin e tij.
17. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore nga Komisioni, konkretisht (i) shkresës së sipërcituar të ASCAL-it; (ii) ushtrimit të veprimtarisë akademike të subjektit të rivlerësimit prej vitit 1998 e deri aktualisht, pa ndërprerje në disa universitete publike dhe jopublike, si janë deklaruar prej tij në deklaratat e interesave privatë periodikë dhe në deklaratën e pasurisë për rivlerësim *vetting*; (iii) angazhimi i pandërprerë pranë Universitetit {***}; dhe (iv) faktet e njohura botërisht, lidhur me administrimin e këtij universiteti, problematikat e pagesave të stafit akademik, siç është deklaruar edhe nga vetë drejtori ekzekutiv i këtij universiteti, z. G. M., në deklaratën noteriale, sipas të cilit pagesat në këtë universitet, në periudhën 2006-2009, bëheshin me vonesë nga zyra e financës së universitetit, dhe për këtë periudhë pagesa për subjektin e rivlerësimit është bërë në vitin 2009, nga zyra e financës së këtij institucioni. Këto problematika në asnjë rast nuk duhet t’i adresohen subjektit të rivlerësimit, pasi qëndrojnë të pavarura nga vullneti i tij. Nga vlerësimi i çështjes në tërësi, bazuar në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, m’u krijua bindja se edhe në kushtet e dokumentacionit jo të plotë provues financiar për këto të ardhura, t’i kërkoja trupit gjykues që minimalisht të shqyrtonte deklaratat e depozituara në Kolegj me ankimin, nga subjekti i rivlerësimit, i cili në bindjen time ka qenë i vërtetë në pretendimin e tij si gjatë hetimit administrativ në Komision, ashtu edhe në ankimin e tij në Kolegj.
18. Në përfundim, konkluzioni i shumicës së trupit gjykues për mosmarrjen në cilësinë e provës të këtyre deklaratave, me arsyetimin se nuk “kënaqin” kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, është i gabuar, pasi ka rezultuar e provuar se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë prova për ta bindur Komisionin që me të vërtetë ka pasur të ardhura të ligjshme për periudhën 2007, 2008 dhe 2009, nga mësimdhënia pranë Universitetit {***}. Në kushtet kur këto prova nuk janë marrë parasysh nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit Ilir Mustafaj ka synuar të përforcojë për sa ka pretenduar në Komision, nëpërmjet deklaratave të paraqitura në Kolegj, mosmarrja parasysh e të cilave, në vlerësimin tim, ka cenuar rolin e gjykatës si instancë e vetme për zgjidhjen e çështjes në bazë të provave e fakteve në përputhje me legjislacionin në fuqi, për dhënien e një vendimi të drejtë.
Vlerësoj se mosshqyrtimi i këtyre deklaratave noteriale në Kolegj dhe mosçelja e debatit gjyqësor kanë cenuar të drejtën themelore të subjektit për t’u mbrojtur përgjatë procesit të rivlerësimit. Gjykata ka përgjegjësi për të garantuar sigurimin e procesit të rregullt ligjor sipas KEDNj-së. Prosesi i rregullt ligjor është garanci me rëndësi jetike në çdo shoqëri demokratike, kështu që neni 6 i Konventës është një ndër dispozitat më të rëndësishme dhe më të atakuara të kësaj Konvente.
Vlerësoj se të ardhurat nga mësimdhënia në vlerën 664.200 lekë, duhet të përlllogariteshin në analizën financiare të vitit 2009, si të ardhura të ligjshme, duke përmirësuar ndjeshëm, dhe në mënyrë të drejtë, gjendjen financiare të subjektit të rivlerësimit për këtë vit.
19. *Për analizën financiare për periudhën 1.1. 2011 – 10.06.2011*, Komisioni në vendimin e tij ka arritur në përfundimin se, *me të ardhurat e ligjshme, subjekti nuk ka pasur mundësi për të*

shlyer këstet e kredive bankare për të përbulluar shpenzimet jetike dhe për të kursyer likuiditete cash ose në llogaritë bankare, si dhe për shpenzime të tjera, duke rezultuar me një bilanc negativ në vlerën -1.070.885 lekë.

Ndërsa shumica e trupit gjykues të Kolegjit konkludon që balanca negative, e përlllogaritur nga Komisioni për këtë periudhë kohore në vlerën (-) 1.070.885 lekë, konfirmohet dhe subjekti gjendet në mungesën e burimeve të ligjshme, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

20. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, nuk gjej të drejtë, konkluzionin e shumicës së trupit gjykues në Kolegj, për moskonsiderimin në analizën financiare të kryer për periudhën 01.01 - 10.06.2011, të ardhurat nga pjesëmarrja në grupin e punës në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga Universiteti “{***}” në maj të vitit 2011, e pasqyruar si e ardhur në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2011, pasi fakti që ka paraqitur dokument, ku specifikohet emri i subjektit si referues në këtë konferencë dhe e ka deklaruar të ardhurën më sipër në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011, më krijojnë bindjen që kjo e ardhur duhet të ishte konsideruar në analizën financiare të kryer në Kolegj. Sa më sipër, do të ndikonte në përmirësimin e pozitën financiare të subjektit për këtë vit.
21. Shumica e trupit gjykues arriti në konkluzionin se në Kolegj, totali i diferencave negative rezultuar nga analizimi i pasurive të subjektit dhe personit të lidhur, ka rezultuar në vlerën 2.695.612 lekë dhe në përfundim, në zbatim të parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit, konfirmon mungesën e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, që ka rezultuar në Komision.
22. Në cilësinë e relatores, çmoj se ky konkluzion i shumicës së trupit gjykues, është rezultat i një analize ligjore të gabuar, me pasojë në rezultatet e analizës financiare të kryer. Kolegji ka për objekt shqyrtimi vendimet e Komisionit, e në rastin konkret, nuk evidentoj se ku konsiston “rëndimi i pozitës” së subjektit të rivlerësimit, siç pretendon shumica e trupit gjykues, duke qenë se:
Së pari, Komisioni, në vendimin e tij nr. 180, datë 18.07.2019, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
Së dyti, gjykoj se jo domosdoshmërisht rezultatet e analizës financiare të kryer në Kolegj, duhet të përkojnë me ato të arritura në Komision, pasi në Kolegj, analiza financiare kryhet në përputhje me vlerësimin ligjor të shkaqeve të ankimit, parashtrimeve, bazuar në aktet e administruara. Shqyrtimi i çështjes në Kolegj është i pavarur nga ai i Komisionit. Kolegji si shkallë e dytë gjykimi në procesin e rivlerësimit, ka detyrimin ligjor të vendosë në bazë të gjykimit të tij, për lënie, ndryshim apo prishje të vendimit, sipas parashikimeve të nenit 66, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe sipas rastit, të orientojë Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, në zbatim të pikës 2 të këtij neni. Në rastin konkret, çmoj se Kolegji duhet të kishte rivlerësuar bilancin negativ, duke marrë në konsideratë në analizë të gjitha provat si kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, pasojë e të cilave do të ishte përmirësimi i situatës financiare dhe jo përkeqësimi i saj.
23. *Konkluzioni më sipër, është rezultat i shumës së diferencave negative të rezultuara nga analiza financiare e viteve 2009, 2013 dhe periudhës 01.01 – 10.06.2011. Në asnjë çështje deri aktualisht, nuk rezulton që në vlerësimin përfundimtar të mjaftueshmërisë ose pamjaftueshmërisë së burimeve financiare për subjekt rivlerësimi, të jetë konsideruar analizë e pjesshme vjetore, por në çdo rast vlerësimi tërësor konsiston në rezultatet e analizës financiare të kryer për gjithë periudhën e rivlerësimit 01.01.2003 – 31.12.2016. Sjell në vëmendje se analizë e pjesshme kryhet vetëm në rastet kur vlerësohet mundësia financiare e subjektit dhe/apo personave të lidhur, për të krijuar me të ardhura nga burime të ligjshme, pasuri [të luajtshme (automjete, likuiditete cash në banesë apo depozitë në bankë)] të*

paluajtshme] me konsideratë deklarimet e subjektit në deklaratat e interesave privatë apo nga të dhënat e dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ.

24. Për sa sipër arsyetuar, e gjej termin **“në total ”** të papërshtatshëm për t’u përdorur në rastin konkret, pasi ky term duhej të përdorej vetëm në rastin kur shuma do t’i korrespondonte totalit të diferencave për vitet që do të kishin rezultuar negativ pas analizës financiare të kryer për çdo vit të periudhës 01.01.2003 – 31.12.2016.
25. Nisur nga fakti që Komisioni nuk ka pasqyruar në vendimin nr. 180, datë 18.07.2019, një analizë të plotë financiare për të gjithë periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016, ndërkohë që i ka kaluar barrën e provës subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, vlerësoj se me tendencë ka rënduar pozitën financiare të subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur shumatoren e diferencave negative për dy vite e gjysmë. Për më tepër, nëse në analizën e kryer do të kishte konsideruar të ardhurat nga mësimdhënia në Universitetin {***} në vitin 2009, dhe të ardhurat nga pjesëmarrja në konferencën ndërkombëtare në vitin 2011, me arsyetimin më sipër, vlerësoj se pozita financiare e subjektit do të përmirësohej. Ndryshim pozitiv të dukshëm në rezultatin financiar do të kishim në rast se shpenzimet jetike përlllogaritëshin sipas shkresës nr. {***} prot., datë 04.03.2019, të ILDKPKI-së. Mosaplikimi i këtij varianti në përlllogaritjen e shpenzimeve jetike nga Komisioni, në vlerësimin tim ka rënduar pozitën financiare të subjektit të rivlerësimit.
26. Sipas vlerësimit tim, në asnjë rast përgjatë shqyrtimit të çështjes në Komision dhe Kolegj, nuk u evidentua tendencë për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit, sa i takon kriterit të vlerësimit të pasurisë.

II

27. Procesi i rivlerësimit në Komision është finalizuar vetëm për një kriter, në respektim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për kriterin e vlerësimit të pasurisë (ka në pronësi një pasuri të paluajtshme dhe likuiditete në bankë), por nëse Komisioni do të kishte vlerësuar drejt faktet e provat e administruara për këtë çështje, si parashtruar më sipër, për rastin konkret, për balancë, do të duhej të kishte bërë edhe një hetim për dy kriteret e tjera, nga ku do të rezultonte që ky subjekt dallon dukshëm nga subjekte të tjera të rivlerësuara deri aktualisht, për një sërë arsyesh:
 - ✓ finalizimi i studimeve me Medalje të Artë;
 - ✓ fitimi i gradës shkencore “Doktor në Fushën e së Drejtës Civile” në vitin 2010;
 - ✓ titulli akademik “Profesor i Asociuar” në vitin 2012;
 - ✓ titulli “Profesor” në vitin 2016;
 - ✓ botimet e shumë librave në këtë fushë dhe publikimi i një numri artikujsh shkencorë në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - ✓ kontributi i tij në formimin e juristëve të rinj;
 - ✓ përvoja e subjektit prej 23 vitesh në sistemin e drejtësisë, dhe 23 vjet eksperiencë akademike paralelisht, duhet të merreshin në konsideratë nga shumica e trupit gjykues përgjatë shqyrtimit të çështjes dhe vendimmarrjes.
28. Në funksion të sa më sipër, citoj faktin që si në Komision, ashtu edhe në Kolegj, për subjektin e rivlerësimit Ilir Mustafaj, nuk është paraqitur asnjë denoncim nga publiku, fakt që tregon se subjekti gëzon reputacion shumë të mirë, në cilësinë e gjyqtarit, gjë që e përforcon bindjen time që ky subjekt rivlerësimi duhet të vijonte të ishte pjesë e sistemit të drejtësisë.

29. Në përfundim të analizës faktike, e udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, i propozuar për të parën herë që prej fillimit të procesit të rivlerësimit e deri aktualisht, kam kërkuar që ky subjekt të vijojë të ushtrojë funksionin e gjyqtarit.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi